

TC KREMTET E JENARIT

1. *Rethprerja e Zotit tone Jesú Krisht; Shen Basili i Math, Ati yne i Shenjte, kryepeshkopi i Kesarise se Kapadokise.*

PERLESHORJA E SHEN BASILIT, T. I.

Ne tere dhene dolli fama jote, se ajo ka pritur fjalen tende, kur perhape dogmat e perendishme, madheshtove natyren e gjerave, riformove zakonet e njeresve, Shen Basil Kryeprift, Ate Oshenar, lutju Zotit Krisht Perendi, te shpetohen shpirtet tona.

PERLESHORJA E RETHPRERJES, T. I, TU LITHU SFRAGISTHENTOS

Fytyre njerezore more pa u-ndryshuar, mi natyren e perendishme, o Zot i zemerdhempshur;

dhe ligjen e permbushe ploterisht, rethprerjen kur durove truperisht, dhe na preve me gershere perfunderisht, pesimet e ertesires. Lavdi miresise sate o Krisht, lavdi dhempsherise sate, lavdi bashkezbritjes sate se patreguar o Fjale.

THIRRTORET, T. IV, O EKS IPSISTU.

I emruar sipas mbrerterve, dhe i shenjteruar si Kryeprift i Math, kullote grigjen e Zotit Krisht, me urtesine, dhe diturin' e thelle te Shpirtit Shenjt; Mbreti pra i jeteve, hir dhe bekim te dha, dhe te stolisi Basil me nam, me nje kurore, ne Mbreterine qellore Zot' i Math, qe lavderohet ne nje Trini, tok me Birin Jesu dhe me Shpirtin Shenjt; nermjetó te na fale, hir dhe ndjese te mekátave.

I dekoruar me Kryqin e cemuar, veshur si nje Kryeprift perpara popullit, leçit Ungjillin e Zotit Krisht, ne mes te Kishes, dyke perhapur drite dhe ngazellim; dhe ne te ndricuarit, po lavderojme sot, nje Perendi edhe Zotin Krisht, te vetmlindur, Birin dhe Shpirtin perpara jeteve, ne nje Trini te bashkeqenshime, te pandare edhe te perjetshime; nermjetó te na fale, hir dhe ndjese te mekátave.

Na ke meshuar me Engjecj permi dhene, dhe tani me ta meshon Ate Basil i Math; se ne jeten rrojte si nje Shenjtó, i lumeruar, dhe i shkelqyer prej virtutave, ndonese me trup njerezor dhe te natyreshme, ke qene si shpirt i palendesh-

me; né qe shijojme, mesimet e tua te hýjeshme, prej erresires dhe prej rezíkeve te padijes; Jesújt Perendí iu-lut, te na fale shpetimin, edhe ndjesen e mekátave.

LAVDI, T. T. I. Shtive dashurí per urtesine, preferove jeten me Perendine, i shtype pasionet e trupit, edhe e lartesove shpirtin me virtuta, Shen Basíl Kryepríft i Math. Nermjetó perpara Krishtit, tu dhuronje shpírteve tona, perdellimin e math.

TANI. U-perunje o Shpetimtár, per gjindjen njerczore, u-pecstolle me shperginjte si foshnje, dhe durove rethprerjen pas tete ditesh. Atí pra o besnike le t' i therresim: Ti je Perendia yne, meshirona.

PASVARGJET, T. T. I, KHERIS ASKITIKON

Lum ti o instrumént muzikál, i frymesuar prej Jesújt dhe prej Engjercjve, qe fole dhe predikove, dhe keshillove me zell, edhe na mesove te pendóhemi; i urte i arte Shenjt, dallendryshe kendónjese, pullúmp i bukur, ligjeronjes i psálmeve, si florí shkelqén ne luáth te virtútave; krua midis lendínave, qe rjeth midis lúleve, o goj' e shenjte qe solle, vellazerí midis njercsve. Iu-lut Jesú Krishtit, te na fale kurdohere, meshire dhe shpetím.

Lum ti qe mpron jetimet si At, ti o perkrahje e te gjithë te shtýpurve, o mprojtje e varferise, dhe i urise ushqím, ndreqje e shigúrt' e mekátá-

reve; o mjeku i shpírteve, dhe i gjithë lengátave, ti o mesonjes, theollóg i doktrínave, ti qe na shpjegón Testamentet e Shpirtit Shenjt; ligje qe çapet na caktón, kanún qe na shpie drejt, o teorí dhe praktike, o urtesí pa kufí dhe funt. Iu-lut Jesú Krishtit, te na fale kurdohere, meshire dhe shpetím.

Ti o pallát i lare me ar, plot me virtuta, dhe zilí shenjterónjese, se ty te bene banese, si nonjë tempull qellór, ty o At i Shenjte Kryepríft i Math; se urte dhe plot me ment, veperimet e ndjénjave, i qeverise, edhe shpirtin e rúajte, si thesár te math lark pesímeve çthúrese; pra si i par' i Engjercjve, u-çfaqe o Shenjt i Math, o Kryepríft i bekuar, edhe kollona i kísheve. Iu-lut Jesú Krishtit, te na fale kurdohere, meshire dhe shpetím.

LAVDI DHE TANI, T. II. Ti qe pas tete ditsh, rethprerjen e durove, degjoje Shen Basilin, dhe Nenen Shen Marine, qe luten gjithenjé per né.

NDENJESORET, T. T. I,
TON SINANARKHON

O luadhi i Fjalcs dhe i Shkriptúrave, qe na ben te besojme dhe te pendóhemi, qe durove gjithë ngasjet e demóneve, né besníket o Basíl, dhe dishépujte me mall siç duhet po te nderojne, se lutesh perpara Zotit, per shpetím te gjithë shpírteve.

LAVDI DHE TANI. Virgjereshe dhe Nene

Marí Hyjlíndese, qe hidherimin e Eves e ktheve ne gezim, te hymnojme né besniket dhe te fálemi, se na çlirove ploterisht, nga mallkimi prinderór o Zonj' e permibekuar, pra lutu per né pa prere, dhe shpetona prej rezíkeve.

T. I, TON TAFON SU

Basíl o Kryeprift, qe je prane Trinise, iu-lut per gjithë né, qe te lusim me besë, ne ditën e tmérrshime, dhe ne gjyqin e fájeve, eja nermjetó, qe te na ndjehen mekatat, se me goj' e shpirt, po te kendojme perherë, o miku i njéresve.

LAVDI DHE TANI. O Krisht o Krijetár, Zot i botes se tere, qe je me Atin tok, dhe me Shpirtin e Shenjte, si foshnje u-rethpreve sot, permi dhene pas tete ditsh. Vepr' e hýjeshme, dhe e çudíqime eshte, kjo qe ben per né, se per shpëtimin e botes, permbushe Kanunin sot.

T. T. IV, TIN SOFIAN

Me fuqine mendore po i permbýs, qe te gjith' heretiket pa perjashtím, doktrinat e shtrémbera, t' Ariosit plot me terbím; edhe leçite ne botën, Jesune si Perendí, edhe armiqtë i çthure me zgjatjen e dúarve; tutje e largove, heresín' e Sabelit, dhe rremat e çméndura, te Nestorit i çduke krejt; Kryeprift Shen Basíl i Math, lutu-i Jesújt Perendí, te na fale ndjesen e mekátave, sot qe kremtojme te gjithë, bescrisht kujtimin tent.

LAVDI DHE TANI. Shpirtin tim te perunjur o Shen Marí, qe ne shqoten e jetes brenda ne det,

po rrihet prej éreve, dhe perpiqet prej válave, edhe nga barr' e mekatit, po mbytet prej újeve, edhe ne funt te Ferrit po kridhet taní me vrap; eja Virgjereshe, dhe me lutjet e nxehta, shpëto me dhe shpërme shpejt, ne limán dhe ne qetsí; se me besë po te therrés: Lutu-i Zotit Jesú Krisht, te na dhuronje ndjesen e mekátave; se me ty kemi shprese, gjithë te pavýerit.

SHKALLESA KREMTORE, T. IV

Qe prej djalerise, shume pasione me leftojne, po ti perkrah-me dhe shpëto me, o Shpëtimtari im.

Ju qe urreni Sionen, do te turperóheni prej Zotit, dhe do te físhkeni si bari ne zjarr.

LAVDI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, merr jete çdo shpirt, dhe lartesohe ne paqesí, dhe ndriçohet prej njesise Trinisore mistikerisht.

TANI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, rjedhin burimet e hirit, edhe vaditin tere kriesen per jetelindje.

PARÇVARGU. Goja ime do te flase urtesí, dhe zemra ime kupetím.

UNGJILLI I MËNGJJEZIT PAS JOANIT

Zoti u tha Judenjve, qe i kishin ardhur: "Me te vertete, me te vertete po ju them: Aý, qe nuke hyn nga dera ne hoborrin e dhenve, po ngjitet gjétkazi, aý eshte vjedhes edhe kusár, edhe aý, qe hyn nga dera, aý eshte bariu i dhenve. Atí ia hap deren portari, dhe aý i therrét me emer

dhente, dhe i nxier jashtë. Dhe kur i nxier jashtë dhente, barët përpara atyre, dhe dhente i venci pas, se ia njohin zerin. Se nuk i venci pas një të huaji, po ikin prej tij, se nuk ua njohin zerin të huajve.” Këtë parabolë ua tha Jesúj, po nuk i múarve vesh ató, që u thoshte. Jesúj, pra, u tha perscrí: “Me të vertete, me të vertete po ju them se unë jam dera e dhenve. Të gjithë atá, që kanë ardhur përpara meje janë vjedhes edhe kusare, edhe dhente nuk i degjuan. Unë jam dera. Aý, që hyn me anën time, do të shpëtonjë, dhe do të hyjë, dhe do të dalë, dhe do të gjenjë kullotjë.”

Psalmi 51 pa ze.

LAVDI. Me nermjetimet e Kryepërfittit, o meshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

TANI. Me nermjetimet e Hyjlíndesës, o meshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

Meshirome, o Perendí meshireplót, edhe shúaji paudhesít' e mia.

T. T. II. Buzet të derthnë hir, Basíl o At' i Shenjtë, edhe Barí u-bere, i Kishes dhe leçite, një Perendí dhe një Triní.

SHKURTORJA, T. III, EPEFANIS

Themelí e Kísheve, e patronditur, u-tregove në rëzik, o Kryepërfitt i Zotit Krisht, o theollóg i doktrinave, Gngjell i qellit, Basíl Oshenár i Math.

SHTËPIA

O en' e perkores, o goj' e urtesisë, o themelí e

dógmave, Shen Basíl i Math, që shkrepetin në mendjen e të gjithëve. Ejani ta kremtojmë dhe të ndriçohemi prej shpirtit të tij. Ejani të imitojmë besën edhe zellin edhe perunjësinë e tij, se u-tregua tempull i Perendisë. Perandáj e lavdërojmë, dhe i nderesim me brohorí: Gngjell i qellit, Basíl Oshenár i Math.

SINAKSARI

Me një të ketí múaji, kremtojmë Rethpërrijen mishërore të Zotit edhe Perendisë dhe Shpëtimtarit tonë Jesú Krisht.

Gjithë sot, kujtojmë Basilin e Math, Atin tonë të Shenjtë, Kryepeshkopin e Kesarisë së Kapadokisë.

Gjithë sot, Theodoti, Dëshmori i Shenjtë, e mbarójeten i vrarë me shpatë.

Me nermjetimet e tyre, o Perendí, meshirone. Amín.

ZBRITËSORET, T. II, VITHU ANEKALIPSE dhe STIVI THALASIS

Këndohen që të dyja Zbritesoret e Ujit të Bekuar gjërnë Kengen VIII:

I-A. E tëri e thau fare detin, dhe nëpërsteré të tij' i shpuri, dhe me valat i përmbyti kundërshtarët, Zot' i Math, i fuqíshm' i lúfteve, nder dhe lavdí me ty.

I-B. Shkoj nëpër detin me kembë Israeli

Edhe në sterén' arriu i palagur,
 Po kaloresinë armike Egiptiane
 Zoti e përmbysi në një varr prej valash
 Me çudí dhe tmerr, me të djathten e
 forte.

III - A. Aý që u jep, fuqí besnikëve dhe mbré-
 terve, dhe ballen e tyre lartësón, ka lindur prej
 Hyjlíndesës, dhe vjen për pagezím taní, pra éja-
 ni dhe thírri: Si ty o Perendí s' ka t'jater Shenjt
 gjekúnt, dhe veç teje nuk ka një të drejt' o Zot.

III - B. Né që shpëtuam nga leqet e armikut
 Dhe nga thonj luanësh t' eger të ter-
 buar,

Le ta çelim gojen dhe le të kendojmë
 Fjalë melodie kenge lavderimi
 Se na dha shpëtím Zoti i pakursyer.

IV - A. Degjój zerin tent o Zot Joán Pagezori,
 që po therrët në shkretëtirë, se bumbullive për-
 mi újrat e shuma, dhe e proklamove Birin tent,
 pra me Shpirtin Shenjt frymësohet plotërisht
 edhe të therrët, o urtesí e Perendisë o Zoti Krisht.

IV - B. I paqësuar prej një zeri të shenjtë
 Kendón Profeti perlindjen njëzore
 Dhe i frymësuar po leçít me bujë
 Fjalën e panismë që u-misherua
 Dhe dermój perdhé poteren e armiqve.

V - A. Kryetari i jetës Jesúj, vjen ta lanjë fa-
 jin e Adamit të parë; ndónese ishte Pe-
 rendí, dhe ndónese s' kishte nevojë për paqesím,
 pagezohet në Jordán për mekatat tona; keshtú

me në pajtohet, dhe na falë paqen që kapercén
 çdo mendje.

V - B. Shpirt' i Shenjtë na ka lare prej çdo
 helmi

Të armikut t' erret edhe të pabesë,
 Dhe na ka drejtuar n' udhën e vertetë
 Që na shpë në dëfrím të paafuar
 Q' e fitójn' atá që ka pajtuar Zoti.

VI - A. Lajmetár i Fjales, kandíl i dritës që na
 sjell agimin, del përpara díellit, në shkretëtirë
 dhe i fton të gjithë, të pendohen dhe të pagezo-
 hen, se ja ku vjen Zoti Jesúj, që ta shpëtonjë bo-
 ten prej mekátave.

VI - B. Bir të permallshim me zë të mallen-
 gjyer

Ati prej qellit e proklamój Jesunë:
 Ky tha është Biri i bashkëpanismë,
 Që shkëlqén si díell përmi njëzore,
 Fjal' e Perendisë që u-misherua.

VII - A. Djemat mun në zjarr, një erë prej ve-
 se vërshellénjese, çuditërisht në mes të furrës
 të pangarë i rúajti, me ndihmën e Engjellit. Pra
 në mes të flagës të vesúarit, përhironin me zë
 të math: Zot i Fórcave, o Perendí i Aterve lart
 në qell, je i bekuar.

VII - B. Në mes të lumit i përvëlój drangonjtë
 Aý që Tre Djemat i shpëtój prej furrës
 Dyke shuar zjarrin me vesën prej qellit,
 Dhe keshtú mekatat edhe njollat tona
 Shpirti Shenjt i lau me valat e Jordanit.

VIII - A. Çudí qe nuke ka tregím, na çfaqí furrá e Babillonés, me vesen e qellit; se keshtú dhe lum' i Jordanit, e priti zjarrin qellór te Krishtit, dhe e pagezój krijetarín e krijesés; pra e bekojme dhe e permilavderojme perhere dhe per jete.

VIII - B. Tere krijesa çlirohet dhe gezohet,
 Bij te drites béhemi né bijt' e nates,
 Vetem po helmohet djall' i erresires;
 Pra le ta bekojme Shpetimtarin tone
 Gjithe pópujte qe ishím te mjeruar.

MADHGSHTIMET, T. II

O shpirt madheshtoje, Zonjen e nderuar, mi Forcat Engjellore.

O shpirt madheshtoje, Krishtin qe rethprietet, si foshnje pas kanunit.

O shpirt madheshtoje, Basilin Kryepriftin, qe na stolisi Kishen.

LAVDI. O shpirt madheshtoje, Zotin Perendine, Trinín' e lavdruar te Shenjt' e te pandare.

TANI. O shpirt madheshtoje, Zonjen e nderuar, qe na shpetój nga Ferri.

IX - A. Asnjé gjuhe ne bote s' te kendón dot pas vleres, dhe trubullohet mendja e gjith' Engjercjve, per ty o Virgjereshe, po na prit me miresí pas beses qe te kemi, se ti e di fort mire, qe kemi mall per ty, dhe te madheshtojme perhere, mprojtj' e besnikëve.

IX - B. O çudí pa funt e lindjes permi mendjen, Nus' e ndrícime dhe Nen' e lavdruar,

Me te cilen múarme shpetím te plotte,
 Pra per mireberjen te doretrokasím
 Dhe kendime perhirimi te blatojme.

DËRGIMCSORET, T. III, EPESKEPSATO.

Me mesím dhe diturí, e zbukurove shpirtin tent, dhe ndrite posi díelli, ne zemrat e besnikëve, predikatór i Zotit Krisht, besnik i Shen Marise, Basíl Kryeprift i Math.

E rethpreve trupin tent, sipas kanunit Mozaik, si foshnje tetedítese, o Zoti Krisht o Shpetimtár; dhe u-pecstolle me shpergínj, edhe me qumësht rritesh, o rrites i jéteve.

LAVDGRIMET, T. I, KHERIS ASKITIKON

Pate rethprerje si çilímí, o Bir i Atit, krijetarit te jéteve, qe linde si Fjal' e Zotit, prej Perendie Perendí, dhe u-njerezove pa nonjé ndryshím; edhe pas kanunit, ti qe je permi çdo kanún, na ke çliuar, prej mallkimit te lígjeve, dhe qe lártazi na dhurove bekím dhe hir. Pra sot ketú po mblídhemi, me gas dhe me ngazellím, dhe te kendojme me hymne, te perhirojme me lavderím; dhe lypim me besë, te dhurósh per shpirtet tona, meshirc dhe shpetím.

Bir adoptíf i Zotit Jesú, na u-tregove, pagezím shpirtçór kur merr, dhe Fjalén e Perendise, te bashkeqénshimin Bir, qe prej Atit lindi para jéteve; pa nisje me Atin tok, e leçite o Oshenár, u mbylle gojen, heretíkeve faqezés, si me një rufé

i permbyse kudó perdhé; pra Mbretérín' e qíellit, fitove o Shen Basíl, dhe mbretérón tok me Krish-tin, qe eshte Mbreti i mbréterve; perpara tij lutu, qe besnikeve tu fale, meshire dhe shpetím.

Brenda ne tempull brenda n' alltár, i shenj-teruar, ke sherbyer si Kryepríft, me vepra dhe theorira, me urtesí dhe me ment, veshur me sto-lira te shkelqýera; taní pra ne qíell, perpara Zo-tit o Oshenár, n' alltár te larte, po meshón tok me Engjejte, si ketú mi dhé, neper kishet e një-resve; mos na harró po na kujtó, Basíl Krye-príft i Math, né qe po lusim me besë, kujtimin tent edhe nermjetó; per né kurdoherë, qe Jesúj te na dhuronje, meshire dhe shpetím.

LAVDI, T. T. II. Buzet te derthne hir, Basíl o At' i Shenjte; edhe Barí u-bere, i Kishes dhe le-çite, nje Perendí dhe nje Triní.

TANI, T. T. IV. U-perunje o Shpetimtár, per gjindjen njerezore, u-pechtolle me shpergínj si foshnje, dhe durove rethprerjen pas tete ditesh. Atí pra o besnike le t' i therresim: Ti je Perendia yne, meshirona.

HYRTORJA

Ejani t' i fálemi dhe t' i pergúnjemi Zotit Krisht. Shpetona o i Bir' i Perendise, qe u-reth-preve mishersht, né qe te kendojme Alilluia.

SHKURTORJA, T. III, I PARTHENOS.

Zoti i te gjithave, durój per neve rethprerjen, dhe mekatin njerezór, po e rethprét si i mire,

sot i fal, botes se tere shpetím per jete, pra ne qell, sot po gezohet dhe ngazellohet, Kryepríft' i Krijetarit, dhe yll' i Krishtit, Basili Shenjt i Math.

Kjo Shkurtore kendohet vetem ditën e Motit te Ri. Pas-táj kendohet Shkurtorja Parekremtore e Epifanise.

APOSTULLI

Goja ime do te flase urtesí, dhe zemra ime ku-petím. Degjójini ketó, te gjithë kombet.

Prej Letres se Palit per Kollosianet.

Vellezër, kini mendjen se mos ju genjenje no-një njerí me fillosofira, me genjeshtra te zbrá-zura, me tradita te njëresve, dhe me elementa te botes, edhe jo te Krishtit. Se ne trupin e tij ba-nón Perendia plotersht. Pra, behuni te plotte me anen e atí, i cili eshte kryetari i çdo force dhe i çdo fuqie; me te cilin jini rethprerë me nje rethprerje te padoregatuar, dyke çveshur trupin e mekátave misherore me anen e rethprerjes se Krishtit; me te cilin jini varrosur tok me anen e Pagezimit; edhe me te cilin jini ngjallur tok me anen e beses dhe me veprimin e Perendise, i cili e ngjalli prej se vdékuresh.

UNGJILLI PAS LUKAJT

M' até kohe, barinjte u-kthyen, dyke lavde-ruar dhe dyke brohoritur Perendine per te gji-tha ató, qe degjuan edhe pane, sikunder u ishte folur. Dhe kur u-mbushne tete dite, e rethprene djalin, dhe ia quajtín emrin Jesú, sipas fjales se

Çngjellit. Edhe djali rritej dhe forcohej nga shpirti dhe nga urtesia, edhe hiri i Perendise ishte mi atë. Edhe prinderit e tij venin per mot ne Jerusalém per te kremten e Pashkes. Edhe kur u-be Jesúj dymbedhjetë vjeç, prinderit e tij shkuan ne Jerusalém sipas zakonit te Pashkes, dhe pasi u-mbaruan te kremtet, u-kthyen prapë, po djali Jesú mbeti ne Jerusalém, dhe Josefi dhe e-jema nuk e dinin, po kujtonin se ishte me shoket e udhes. Keshtú udhetuan nje dite. Pastáj, kur nuk e gjetne neper gjirinjte dhe te një-hurit, u-kthyen prapë ne Jerusalém edhe po e kerkonin. Dhe pas tri ditësh e gjetne ne Shenjteroren, ku rrinte ne mes te mesónjesve, dhe po i pyeste. Dhe te gjithë atá, qe e degjonin, çuditëshin per sqojtesine dhe pergjígjiet e tij. Edhe kur e pane prinderit, u-habitne, dhe e-jema i tha: “Bir, ç’ na ke bere keshtú? Ja yt-ate dhe une, qe po te kerkonim me pikellím.” Dhe aý u-pergjéq: “Persé me kerkonit? A nuk e dinit qe duhet te jem ne punet e tim-Ati?” Po atá nuk e kuptuan fjalen qe u tha. Edhe zbriti bashke me prinderit, edhe vajti ne Nazarét, edhe ishte i bindur ner atá. Edhe e-jema i rúante te gjitha ketó fjale ne zemer. Dhe Jesúj perparonte ne urtesí edhe ne moshe dhe ne hir perpara Perendise dhe perpara njëresve.

Pastáj vazhdón Mesha e Shen Basilít. Ne Diptiket kendohet:

MADHËSHTIMI I SHËN BASILIT, T. II.

Leçitëshin qellór te Krishtit, dishépullin e Zotit, yllin e ndriçim nga Kesaria e Kapadókeve, Basilin e Math, le ta nderojme te gjithë.

2. Parekremtja e Epifanise; Silvestri, Ati ynë i Shenjte, Papa i Romes.

PERLËSHORJA E SHËN SILVESTRIT, T. IV, KANONA PISTEOS

Kanún i beses, edhe kor’ e butesise, mesonjes i perkores, ndrite perpara besnikëve, me te verteten e púnëve; perandáj i fitove me perunjesine te lartat, me varferine te pásurat, Atë Shen Silvester Patrik i Math, lutju Zotit Krisht Perendí, te shpctohen shpirtet tona.

PERLËSHORJA E PARÇKREMTES, T. IV, KATEPLLAJI IOSIF

Pregatitu Zabullón, dhe zbukurohu Nefthalím; dhe ti lum i math Jordán, qendró dhe prit-e me gezím, Zotin Jesú qe po vjen per te pagezuar. Ti Ev’ e ti Adám, sot ngazellóhuni, mos u-fshihni mé taní, si ne Parajsen me tmerr; se kur ju pá te çveshur zbriti vete qe tjua kthenje stoline. Na ardhi Krishti, dhe tere boten, dó qe ta perserite.

SHKURTORJA E PARÇKREMTES, T. IV, EPEFANIS SIMERON

Ne Jordán afrohet sot, Mbreti i qellit, Shpëtimtari Zoti Krisht, dhe Shen Joanit i therrët:

Mos u-trondít po me pagezó; vinj per shpetimin, e gjindjes se njëresve.

Kjo Shkurtore kendohet ne Meshe pas Hyrjes se Vogel qe me 2 gjer me 5 te Jenarit. Pas kesáj date kendohet Shkurtorja e Epifanise.

3. *Mallakia, Profeti i Shenjte; Gordi, Deshmori i Shenjte.*

E DIELA PERPARA EPIFANISG

(Qe me 31 te Dhjetorit gjer me 4 te Jenarit)

PERLESHORJA, T. IV, KATEPLLAJI IOSIF

Pregatitu Zabullón, dhe zbukurohu Nefthalím; dhe ti lum i math Jordán, qendró dhe prit-e me gezím, Zotin Jesú qe po vjen per te pagezuar. Ti Ev' e ti Adám, sot ngazellóhuni, mos u-fshihni mé taní, si ne Parajsen me tmerr; se kur ju pá te çveshur zbriti vete qe tjua kthenje stoline. Na ardhni Krishti, dhe tere boten, dó qe ta perserite.

SHKURTORJA, T. IV, EPEFANIS.

Ne Jordán afrohet sot, Mbreti i qellit, Shpetimtari Zoti Krisht, dhe Shen Joanit i therrét: Mos u-trondít po me pagezó; vinj per shpetimin, e gjindjes se njëresve.

THIRRTORET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Ejani nisuni, taní prej Bethlehemit, te shkojme ne Jordanin, se drita n' erresire, atjé po shkrep per njërczit.

Ju qe ne Zabullón, banoni tej Jordanit, degjoni

se afrohet, shpetím' i Jesú Krishtit, çlirimi i te gjithëve.

Bcj-i gatí Jordán, per Jesú Krishtin valat, se vjen te pagezohet, dhe te na perserite krijesat e dermúara.

LAVDI DHE TANI. Mbreti ja ku na vjen, ja shpres' e Israelit, dhe drit' e njerezise, gezóhuni o pópuj, dhe prítieni me brohorí.

PASVARGJET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Eja Shen Jan sherbé, per driten si kandili, per dhénterrin si miku, per Fjalén si Profeti, i madhi Pareréndesi.

Drita ja ku po vjen, shpetimi ja ku çfaqet, pra eni ne Jordanin, te veme ta kendojme, Jesune jetedhénesin.

Solle çdo miresí, o Zonje Virgjereshe, mi dhe-ne Perendine, Jesune ne Jordanin, dhe driten gjithe njëresve.

LAVDI DHE TANI. Krishti na u-fanés, i lindur prej Marise, dhe vjen te pagezohet, ne lumin e Jordanit, prej Shen Joanit Pagezór.

NDGNJESORET, T. I, TON TAFON SU

U-veshe me stolí, njerezore te varfer, dhe vjen si sherbetór, ne Jordán me te tjeret, dhe lype pagezím si rob, prej nje robi o Zoti Krisht, Pagezori pra, Shen Jan te pá dhe therriste: Perendí Jesú, qysh po ma lyp pagezimin, o Zot i meshírave.

LAVDI DHE TANI. Jesúj eshte gatí, nga me-

shira e madhe, të vinje në Jordán, dhe në valat e lumit, shpëtimin e njëresve, ta gatite me hir qëllor; Prit-e me gezim, Profét Joán Pararendes, dhe nër újerrat, siç desherón pagezoje, si mikun e njëresve.

T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

I varfer i pásuri, nga dhempsheria u-be, dhe në të rrezuarit, nëper mekát e mallkím, të pasur na ben me hir; ja se ku vjen të hynje, në Jordán të bekuar, edhe të pagezohet, prej Joán Pagezorit. Hymnójeni me gas, dhempsherin' e pakufishime.

LAVDI DHE TANI. U-mbush profetia sot, e Isaiut Profét, që thoshte Gatiteni, udhën e Zotit me vrap, patekat pra shtrójani, ja se ku oshetiti, një trumbetë një bujë, zeri në shkretëtirë, i Shen Janit me famë; ketú pra eni të gjithë, që ta shohim Zotin Krisht.

Pastáj thuhën këndimet e zakonata të Tíngellit që rasis atë të Diel.

ZBRITGSORET, T. II, VITHU ANEKALIPSE

I-A. E teri e thau fare detin, dhe nëper steré të tijt' i shpuri, dhe me valat i permbyti kundërshtaret, Zot' i Math, i fuqíshm' i lúfteve, nder dhe lavdí me ty.

III-A. Aý që u jep, fuqí besnikëve dhe mbrëterve, dhe ballen e tyre lartësón, ka lindur prej Hyjlíndeses, dhe vjen për pagezím taní, pra éja-

në dhe thírri: Si ty o Perendí s' ka tjetër Shenjt gjekúnt, dhe veç teje nuk ka një të drejt' o Zot.

IV-A. Dëgjój zërin tënt o Zot Joán Pagezori, që po thërrët në shkretëtirë, se bumbullive përmi újerrat e shuma, dhe e proklamove Birin tënt, pra me Shpirtin Shenjt frymesohet plotërisht edhe të thërrët, o urtesí e Perendisë o Zoti Krisht.

V-A. Kryetari i jetës Jesúj, vjen ta lanjë fajin e Adamit të parë; ndónese ishte Perendí, dhe ndónese s' kishte nevojë për paqesím, pagezohet në Jordán për mekátat tona; keshtú me në pajtohet, dhe na falë paqen që kapërcën çdo mendje.

VI-A. Lajmetár i Fjalës, kandíl i dritës që na sjell agimin, del përpara diellit, në shkretëtirë dhe i fton të gjithë, të pendohen dhe të pagezohen, se ja ku vjen Zoti Jesúj, që ta shpëtonjë botën prej mekátave.

VII-A. Djemat mën në zjarr, një erë prej ve-se vërsellënjese, çuditërisht në mes të furrës të pangarë i rúajti, me ndihmën e Engjëllit. Pra në mes të flagës të vesuarit, përhironin me zë të math: Zot i Fórcave, o Perendí i Aterve lart në qell, je i bekuar.

VIII-A. Çudí që nuk ka tregím, në çfaqë furrë e Babillonës, me vesën e qellit; se keshtú dhe lum' i Jordanit, e priti zjarrin qëllor të Krishtit, dhe e pagezój krijëtarin e krijësës; pra e bekojmë dhe e permilavderojmë përherë dhe për jetë.

IX-A. Asnjë gjuhë në botë s' të këndón dot

pas vlerës, dhe trullohet mendja e gjith' En-
gjejeve, për ty o Virgjereshe, po na prit me mi-
resí pas besës që të kemi, se ti e di fort mirë, që
kemi mall për ty, dhe të madheshtojmë përherë,
mprojtj' e besnikëve.

DERGIMËSORET, T. II, TIS MATHITES

Ja zer' i thírresit gjemój, me gas kecejne ma-
let, dhe valle lozin njërczit, se Fjal' e perendish-
me, nga qelli ja ku na zbriti, mori fytyrë robí,
dhe vjen të marrë Pagezím, prej Joán Pagezorit
si mekatár, për shpëtím të njëresve dhe të botes,
në valat dhe nër újerrat, në Jordán të Judesë.

Qysh do të presë lumi sot, o Krisht o njerida-
shës, o Krijetár i bóteve, o Fjal' e perendishme,
dhe si Shen Jani Profeti, ka për të vënë dorën,
mi koken tendë o Jesú, dhe të të pagezonjë si me-
katár, për shpëtím të njëresve dhe të botes, në
valat dhe nër újerrat, në Jordán të Judesë.

LAVDGRIMET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Mbreti ja ku na vjen, ja shpres' e Israelit, dhe
drit' e njërczisë, gëzohuni o popuj, dhe priteni
me brohorí.

Ja ku u-çfaq mi dhé, i mishëruar Zotí, si drita
n' erresirë, si gazi në vajtimin, dhe hiri përmi
njérczit.

Drita u-çfaq për në, lavdí' e Perendisë, në va-
lat e Jordanit, që të na pagezonjë, për ndjesën e
mekátave.

LAVDI. Krishtin e pagezó, Joán o Parëren-

des, se ti e proklamove, si shqerrë Perendie,
shpëtím të mekatárëve.

TANI. E permibekuar je, o Hyjlíndese Vir-
gjereshë. Të hymnojmë, se prej Birit që lindë,
Ferri u-roberua, Adami u-nduall prapë, mallki-
mi vdiq, Eva u-çlirua, vdekja u-dermua, dhe në
múarmë jetë. Perandáj po hymnojmë dhe the-
rresim: I bekuar je, o Krisht Perendí, që e pel-
qeve keshtú, lavdí me ty.

SHKURTORJA, T. IV, EPEFANIS

Në Jordán afrohet sot, Mbreti i qellit, Shpe-
timtari Zotí Krisht, dhe Shen Joanit i therrët:
Mos u-trondít po me pagezó, vinj për shpëtimin,
e gjíndjes së njëresve.

APOSTULLI

Shpëtoje popullin tent, o Zot, edhe bekoje tra-
shegimin tent. Ty do të therrës, o Zot, o Peren-
dia im.

Prej Letres II së Palit për Timothënë.

Bir Timothé, vigjelló për të gjitha, vúaj-i të ke-
qiat, bej-e vepren e Ungjillorit, edhe mbaroje
shërbimin, se unë po shkrinj, dhe me ka ardhur
koha që tju të shëndët. E leftova luftën e mirë, e
mbarova rendjen, e rúajta besën. Taní me pret
kurora e drejtësisë, të cilën do ma japë Zotí, gjy-
kátësi i drejtë, m' até ditë, dhe jo vetëm mua, po
edhe të gjith' atyre, që duan fanesjen e tij.

UNGJILLI PAS MARKUT

Nis Ungjilli i Jesú Krishtit, të Birit të Perëndisë, sikunder kanë shkruar Profetet: “Ja ku ta dergónj lajmëtarin, i cili do ta parëgatitë udhën, i cili do të thërresë me zë në shkretëtirë: Gatitë-jani udhën Zotit, edhe drejtësójani ruget.” Joani po pagezonte në shkretëtirë, dhe leçitëte pagezimin e pendimit për ndjesën e mëkátave. Dhe të gjithë banorët e Judesë dhe të Jerusalemit vënin, dhe pagezoheshin prej tij në lumin e Jordanit, pasi refenin mëkátat. Edhe Joani ish i veshur me një robë prej qimesh të kamiles, dhe ish i ngjeshur me një brez të lekurtë, edhe hante karkalecë dhe mjaltë të eger. Dhe leçitëte, dhe thoshte: “Pas meje vjen një më i fortë se unë, të cilit nukë jam i zoti tja zgjith rripat e këpucëve. Unë ju kam pagezuar me ujë, po aý do tju pagezonjë me Shpirtin e Shenjtë.”

4. *Mbledhja e të Shtatëdhjetë Apostujve të Shenjtë; Theoktisti, Ati ynë Oshenár, abati i Kukumit të Sikelisë.*

PERLESHORJA E APOSTUJVE, T. III.

O Apostuj të Shenjtë, lútjuni Zotit tonë Jesú Krisht, tu falë shpirtëve tona, ndjesën e mëkátave.

5. *Theopempti dhe Theonáj, Dëshmoret e Shenjtë; Sinkletika, Nena jonë Oshenare; Vengjilla e Epifanisë.*

PERLESHORJA E VENGJILLES,

T. T. IV, KATEPLLAJI IOSIF

Mbajti valat dhe qëndrój, lumi Jordán u-ça në

mest, se Profeti Elishé, i ra me gunën edhe shkoj, pas porrosisë që mori nga Shent Elliu; ahërë në u-bë, lumi i shenjës steré, si shembell dhe Mistër, si Pagezím për në, se më këtë nga vahu i jetës përtej po hídhemi. Në ardhi Krishti, përmi Jordanin, t' i bekonjë gjithë újerat.

EPIFANIA

PERLESHORJA E EPIFANISË,

T. I, EN IORDHANI VAPTIZOMENU SU

Kur pagezoheshë në Jordanin o Zot për në, ahërë falja e Shen Trinisë kudó u-çfaq, se zër' i Prindit po në dëshmontë për ty fáqezë, dhe Bir të dashur të tij po të qëante, edhe Shpirti i Shenjtë si një pullúmp, vërtetonte çdo fjalë me shigurí. Ti që u-fanësë Krisht Perendí, dhe ndriçovë botën lavdí me ty.

SHËRBESA E MBRËMCSORES

DHE

MESHA E SHËN BASILIT

Më 5 të Jenarit në mëngjës, pas Oreve të Mëshës, këndohet Mbrëmësorja e Këshëndëllave dhe pastáj behet Mëshë e Shen Basilit, me rëgullen pasónjësë: Passi bekón Prifti, këndohet Psalmi Nistór; pastáj Prifti thotë Litárinë e Madhë; pastáj këndohen Thirrtoret; pas Lavdisë behet Hyrja e Vogel; pas Hyrjes dhe Profetive, këndohet mënjehere Apostulli; dhe pastáj vazhdón rëgullisht Mëshë e Shen Basilit të Math që nga Urata e Apostullit edhe tutje.

THIRRTORET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Krishtin kur e shikój, Shen Jani në Jordanin,

me shpirtin po gëzohej, dhe dora po i dridhej, dhe thosh lavdi me ty o Zot.

Ëngjajta lart në qell, kur panë Shpëtimtarin, që desh të përgëzohej, çuditëshin dhe thoshnin, lavdi me ty o Zoti Krisht.

Biri i dashur je, tha Ati që prej qellit, dhe Shpirti përmi toke, si një pullë të zbriti, lavdi me ty o Zoti Krisht.

Ardhe të na shpëtosh, dhe prite Përgëzimin, që të na lash mekatat, dhe shpirtet të na ndritësh, o Zoti Krisht o Perëndi.

LAVDI DHE TANI. Unjesh o Zoti Krisht, përpara Shen Joanit, në valat e Jordanit, drangonjta i dermove, i ngjalle gjithë njërezit.

APOSTULLI

Zoti është drita ime dhe shpëtimi im. Zoti është mporësi i jetës sime.

Prej Letres I së Palit për Korinthianët.

Vëllezër, ndonëse jam i lirë nga të gjitha, u-bera rob i të gjithëve, që të fitoj ca më tepër për njerëz. Dhe u-bera për Jahudinjtë Jahudi, që të fitoj Jahudinjtë; për jashtëligjësit jashtëligjes, dyke mos qëndër jashtëligjes përpara Perëndisë po nënligjes përpara Krishtit, që t' i fitoj jashtëligjësit. U-bera për të semuret i semure, që t' i fitoj të semuret; u-bera për çdo njeri çdo gjë, që të shpëtosh do-ka me çdo mënyrë. Dhe këtë i bëj për Ungjillin, që të bëhem pjesëtar i tij. A nuk e dini se nga atë, që marrin pjesë në

rendjet e arenës, që të gjithë rendin, po vetëm një del i pari, dhe e merr çmimin. Keshtu, pra, rentni, që të fitoni. Edhe çdo njeri, që merr pjesë në lodrat, është i përmbajtur në çdo gjë; edhe atë duan të marrin një kurorë, që fishket, kur ju doni të merrni një kurorë të pafishkur. Une, pra, rent keshtu, jo me t' erret, keshtu po leftonj, jo në erë. Dhe e qeveris, dhe e robëronj trupin, se nuk dua që tu predikonj të tjerëve, dhe unë vete të jem i çthurur.

UNJILLI PAS LUKAJT

Motin e përcëdhjetë të mbretërimit të Kesarit Tiber, kur ishte Ponti Pillati guvernor i Judesë, dhe Herodi tetrark i Galileës, dhe Filipi, i vellaj, tetrark i Ituresë, dhe i krahinës së Trakonitës, dhe Lisania tetrark i Abilenës, kur Anna dhe Kajafa ishin kryepërfetërinj, Joani i biri i Zaharisë, doli me fjalën e Perëndisë në shkretëtirë. Edhe shetite në tërë krahinën rreth Jordanit, edhe predikonte përgëzimin e pendimit për ndjesën e mekatave, sikundër është shkruar në librin e Profetit Isaia, i cili thote: "Do të thërrëse me zë në shkretëtirë: Gatitjani udhën Zotit, edhe drejtësójani rrugët. Çdo shpellë do të mbushet, edhe çdo mal dhe çdo kodër do të unjet, edhe të shtrëmbërat do të bëhen të drejta, edhe udhët e ashpëra do të bëhen të buta, edhe çdo njeri do ta shikonjë shpëtimin e Perëndisë. Dhe Joani u thoshte atyre, që shkonin të përgëzohe-

shin prej tij: “Ju, o fare prej neperkash, kush ju ka treguar per rezikun e pritme? Eni pendóhuni, dhe provójeni, dhe mos e flini mendjen, se jini bij te Abrahamit. Se ja ku ju them se Perendia munt te benje bij te Abrahamit nga ketá gurc. Ja, taní sepata po i bie drurit ne renje. Çdo dru, qe nuke ben peme te mira, do te pritet edhe do te hidhet ne zjarr.” Edhe njérczit e pyesnin: “Atchere, ç’ duhet te bejme?” Dhe aý u-pergjéq, edhe u tha: “Aý, qe ka dy kemishe, le tja japc njerem atí, qe nuke ka asnjé; dhe aý, qe ka te ngrena, le te benje gjithashtú.” I vajtin edhe disa publikanc, qe te pagezóheshin, dhe e pyetne: “Mesonjes, po né, ç’ duhet te bejme?” Dhe aý u-pergjéq, edhe u tha: “Mos merrni asgjé mé te per seç’ ju eshte caktuar.” Dhe e pyesnin edhe ushtaret: “Po né ç’ duhet te bejme?” Dhe aý u-pergjéq, edhe u tha: “Mos mundoni dhe mos kallezoni asnjé njerí, dhe kenáquni me rogat tú-aja.” Dhe kur njérczit mejtóheshin me veten e tyre se mos Joani ishte Krishti, dhe qe te gjithc prisnin çkoqitje per keté çeshtje, Joani u-pergjéq, edhe u tha: “Une ju pagezónj me uje, po vjen nje tjater mé i forte se une, te cilit s’ jam i zoti tja zgjith rripat e kepúceve. Aý do tju pagezonje me Fryme te Shenjte dhe me zjarr; aý, me lopaten ne dorc, do ta qeronje lemen, dhe do ta mbledhc grurin ne hambár, edhe kashten do ta djegc ne zjarrin e pashuar.” Edhe predikonte

shume gjera te tjera, dhe e keshillonte pópullin.

Per Bekimin e Math te Ujit shikó ne Uratoren, f. 403.

SHCRBESA E MCGJJEZIT DHE MESA E SHGN JOAN GOJARTIT

NDENJCSORET, T. III, TIN OREOTITA

U-çfaqc ne Jordán, o Jetedhencs, more Pagezím, prej Shen Joanit, dhe prej Atit Bir i dashur u-proklamove; i bashkepanisme pra, tok me Atin u-çfaqc ti, dhe prej qellit Shpirti Shenjt, mi ty zbreti si nje pullúmp; dhe né pra te ndriçuar the- rresim: Krisht i Trinise meshirona.

LAVDI DHE TANI, *gjithajó.*

T. IV, KATEPLLAJI IOSIF

Ti o lume o Jordán, sa u-çudite kur e pé, te paparin lakuríq, pash’ e u-tremba thot’ aý, dhe si te benja un’ i mjeri dhe si te duronja; Engjejte ne qell, pan’ e çuditeshin, dhe qell’ i ter’ u-shtank, edhe dheu u-trondít, dhe u-tmerruan te gjitha te dúkurat dhe te padúkurat. Na ardhi Krishti, per te bekuar, ne Jordán gjithc újcrat.

LAVDI DHE TANI, *gjithajó.*

T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Jordanin bekove sot, o Perendí dhe Zot, me- katin e shove krejt, me Pagezimin, qe more per né o Krisht; u-unje nene pellemben, e Joán Pa-

gezorit, dhe njërczit i shpetove, nga genjeshtrat e djallit, të gjithë pra të lútemi: Ti na shpetó o Zot.

LAVDI DHE TANI, *gjithajó*.

SHKALLESA KREMTORE, T. IV

Që prej djalerisë, shumë pasione më leftojnë, po ti perkrah-më dhe shpetomë, o Shpëtimtari im.

Ju që urreni Sionen, do të turpëroheni prej Zotit, dhe do të fishkeni si bari në zjarr.

LAVDI. Më anën e Shpirtit të Shenjtë, mërr jetë çdo shpirt, dhe lartësohet në paqesí, dhe ndriçohet prej njesisë Trinisore mistikërisht.

TANI. Më anën e Shpirtit të Shenjtë, rjedhin burimet e hirit, edhe vaditin tërë krijesën për jetelindje.

PARCVARGU. Deti të pá edhe iku, Jordani u-kthye prapë.

UNGJILLI I MËNGJËZIT PAS MARKUT

M' atë kohë, ardhí Jesúj nga Nazareti i Galilese, dhe u-pagezua prej Joanit në Jordán. Dhe menjëherë, kur po dilte nga uja, pá se qelli u-ça, edhe Shpirti i zbriti më kokë si një pullúmp. Dhe u-degjua një zë nga qelli: "Ky është im-Bir i dashur, që më ka pelqyer."

Psalmi 51 pa zë.

LAVDI, T. II. Sot le të ngazellohet e tërë bota, se Krishti u-fanës në mes të Jordanit.

TANI, *gjithajó*.

Mëshirome, o Perëndí meshireplót, edhe shúaji paudhesít' e mia.

T. T. II. Vajte sot në Jordán, të pá dhe tha Shen Jani: Jam robi ti je Zoti, si të të pagezónj pra, lavdí më ty o Perëndí.

ZBRITËSORE DYPLIKE, T. II, VITHU ANEKALIPSE dhe STIVI THALASIS

(Që më 1-6 të Jenarit këndohen që të dyja tok, A dhe B, pastáj që më 7-14 të Jenarit këndohen vetëm të dytat, të markúara më letren B.)

I-A. E tëri e thau fare detin, dhe nëpër steré të tijt' i shpuri, dhe më valat i përmbyti kundërshtaret, Zot' i Math, i fuqíshm' i lúfteve, ndër dhe lavdí më ty.

I-B. Shkoj nëpër detin më kembë Israeli
Edhe në sterén' arriu i palagur,
Po kaloresinë armike Egjiptiane
Zoti e përmbyti në një varr prej valash
Më çudí dhe tmerr, më të djathten e
forte.

III-A. Aý që u jep, fuqí besnikëve dhe mbrëterve, dhe ballen e tyre lartësón, ka lindur prej Hyjlíndeses, dhe vjen për pagezím taní, pra éjani dhe thírrini: Si ty o Perëndí s' ka tjetër Shenjt gjekúnt, dhe veç teje nukë ka një të drejt' o Zot.

III-B. Né që shpëtuam nga leqet e armikut
Dhe nga thonj luancsh t' egrë të ter-
buar,
Le të çelim gojen dhe le të këndojmë

Fjale melodie kenge lavderimi
Se na dha shpetim Zoti i pakursyer.

Pastaj kendohet pa ze:

HIPAKOJA. Kur e ndrite boten e tere me Epifanine, atehere iku deti i kripur i pabesise, dhe Jordani u-kthye perpjete ne qell. Atje lartesa me porrosit' e tua, o Krisht, o Perendi, me nermjetimet e Hyjlindeses, edhe meshirona.

Vazhdojne Zbratesoret:

IV - A. Degjoj zerin tent o Zot Joán Pagezori, qe po therrët ne shkretetire, se bumbullive permi újrat e shuma, dhe e proklamove Birin tent, pra me Shpirtin Shenjt frymesohet plotërisht edhe te therrët, o urtesí e Perendise o Zoti Krisht.

IV - B. I paqesuar prej nje zeri te shenjtc
Kendon Profeti perlindjen njerezore
Dhe i frymesuar po leçit me bujc
Fjalën e panisme qe u-misherua
Dhe dermój perdhé poteren e armiqve.

V - A. Kryetari i jetes Jesúj, vjen ta lanje fajin e Adamit te paretreguar; ndonese ishte Perendi, dhe ndonese s' kishte nevojë per paqesim, pagezohet ne Jordán per mekatat tona; keshtú me né pajtohet, dhe na fali paqen qe kapercén çdo mendje.

V - B. Shpirt' i Shenjte na ka lare prej çdo
helmi
Te armikut t' erret edhe te pabese,

Dhe na ka drejtuar n' udhen e vertete
Qe na shpie ne defrim te paafruar
Q' e fitojn' atá qe ka pajtuar Zoti.

VI - A. Lajmetár i Fjales, kandil i drites qe na sjell agimin, del perpara díellit, ne shkretetire dhe i fton te gjithë, te pendohen dhe te pagezohen, se ja ku vjen Zoti Jesú, qe ta shpctonje boten prej mekátave.

VI - B. Bir te permallshim me ze te mallengjyer

Ati prej qellit e proklamój Jesune:
Ky tha eshte Biri i bashkepanisme,
Qe shkelqén si díell permi njerezine,
Fjal' e Perendise qe u-misherua.

SHKURTORJA, T. IV, EPEFANIS

Kjo Shkurtore kendohet ne Meshe pas Hyrjes se Vogel qe me 6-14 te Jenarit. Pas kesaj date kendohet Shkurtorja e Perhasjes.

U-fanese me lavdí, ne tere boten, edhe drita jote sot, na u-shenua me çudí, pra te hymnojme me kupetim: Ardhe u-duke, o drit' e paafruarshme.

SHTËPIA

Ne Galilén' e Gjenteleve, ne krahinen e Zabullonit, dhe ne qarkun e Nefthalimit, ka shkelqyer Krishti, drita e madhe, sikunder tha Profeti. Prej Bethlehemit vetetiu dhe ndriti agimi per te ertesuarit, prej Marise i lindi Zoti, díelli i drejtësisë, reze tere botes. Perandáj éjani te gjithë te

ngróhemi prej tij. Se ngrohje per te çvëshurit edhe drite per te erresúarit ardhe, u-duke, o drit' e paafrúarshme.

SINAKSARI

Me 6 te ketí múaji kremtojmë Epifanine e Zotit edhe Perendise dhe Shpetimtarit tone Jesú Krisht.

E atí eshte lavdia dhe fuqia ne jetet e jéteve. Amín.

Pastáj vazhdojne Zbratesoret:

VII - A. Djemat mun ne zjarr, nje ere prej vese vershellénjese, çuditerisht ne mes te fures te pangare i rúajti, me ndihmen e Engjellit. Pra ne mes te flages te vesúarit, perhironin me ze te math: Zot i Fórcave, o Perendí i Aterve lart ne qell, je i bekuar.

VII - B. Ne mes te lumit i pervelój drangonjte Aý qe Tre Djemat i shpetój prej fures Dyke shuar zjarrin me vesen prej qellit, Dhe keshtú mekatat edhe njollat tona Shpirti Shenjt i lau me valat e Jordanit.

VIII - A. Çudí qe nuke ka tregím, na çfaqí ferra e Babillonës, me vesen e qellit; se keshtú dhe lum' i Jordanit, e priti zjarrin qellór te Krishtit, dhe e pagezój krijetarin e krijesës; pra e bekojme dhe e permilavderojme perhere dhe per jete.

VIII - B. Tere krijesa çlirohet dhe gezohet, Bij te drites béhemi né bijt' e nates, Vetem po helmohet djall' i erresires;

Pra le ta bekojme Shpetimtarin tone Gjithe pópujte qe ishim te mjeruar.

MADHESHTIMET, T. II.

O shpirt madheshtoje, Zonjen e nderuar, mi forcat Engjellore.

O shpirt madheshtoje, até q' u-pagezua, ne lumin e Jordanit.

O shpirt madheshtoje, até qe prej Joanit, per né u-pagezua.

O shpirt madheshtoje, até qe u-deshmua, prej Atit lart nga qelli.

Sot Jesú Krishti unji, kryet nene doren, e Shen Joán Profetit.

Sot Shen Joán Profeti, e pagezón Jesune, ne valat e Jordanit.

Sot po deshmohet Krishti, prej Atit lart nga qelli, si Bir i tij i dashur.

LAVDI. O shpirt madheshtoje, Zotin Perendine, Trinín' e lavderuar, te shenjt' e te pandare.

TANI. O shpirt madheshtoje, Nenen Virgjereshe, qe na shpetój nga Ferri.

IX - A. Asnjé gjuhe ne bote s' te kendón dot pas vleres, dhe trubullohet mendja e gjith' Engjexjeve, per ty o Virgjereshe, po na prit me miresí pas beses qe te kemi, se ti e di fort mire, qe kemi mall per ty, dhe te madheshtojme perhere, mprojtj' e besnikëve.

IX - B. O çudí pa funt e lindjes permi mendjen, Nus' e ndrícime dhe Nen' e lavderuar,

Me te cilen múarme shpetím te plotte,
Pra per mireberjen te doretrokasim
Dhe kendime perhirimi te blatojme.

DERGIMSORJA, T. III, EPESKEPSATO

Na u-çfaq Shpetimtari Krisht, me te verteten plot me hir, ne valat e Jordanit sot, dhe gjithë t' erresúarit, dhe te fjéturit i zgjoj, se ardhi dhe na ndriti, si drita e díellit (*3 here*).

LAVDERIMET, T. I

Drite prej drite, i ndriti botes Krishti Perendia yne (*2 here*).

Si te te nderojme pas vleres, né sherbetoret ty Zotin? Se ti na perscrive ner újerat.

U-pagezove ne Jordán o Shpetimtár, dhe i shenjterove újerat, sherbetori ta vuri doren mi koke, dhe i sherove vojttjet e botes. Misteri i ekonomise sate esht i math, o Zot njeridashes lavdí me ty.

Drita e vertete na u-fanés, edhe i ndriti te gjithë. Krishti u-pagezua per né, dhe na i spastrój mekatat e shpirtit. Ngjarja esht e dheshme, po kupetimi eshte qellór, se zbriti nene ujen dhe na ngriti me Perendine. Veprat e tua jane te çudíçime, o Zot lavdí me ty.

Aý qe e peshtjell qellin me rete, hyn sot nene valat e Jordanit, edhe i spastrón mekataret, aý qe ngre mekatin e botes edhe deshmohe qe lár-tazi prej Shpirtit te Shenjte, edhe proklamohet

prej Atit Bir i Vetemlindur. Atí le ti therresim te gjithë: Ti qe u-fanese dhe na shpetove, o Krisht o Perendia yne lavdí me ty.

LAVDI, T. T. II. U-ceshtolle me valat e Jordanit o Shpetimtár, ti qe vishesh me driten si robe, dhe ia unje koken Pareréndesit, ti qe ke matur qellin me pellemben, qe ta kthesh boten nga genjeshtra, dhe t' i shpetósh shpirtet tona.

TANI, T. II. Sot Krishti vajti ne Jordán qe te pagezohet. Sot Joani ia ve doren mi koke Zotit. Forcat Engjellore u-çuditne, kur e pane keté mistér te habiçim. Deti e pá edhe iku, Jordani u-kthye prape. Edhe né te ndriçuarit po therresim: Lavdí Perendise qe u-fanés, edhe u-duk mi dhene, dhe e ndriti boten.

Per Bekimin e Math te Ujit, qe behet pas Doksollogjise, shikó ne Uratoren, f. 403.

HYRTORJA

I bekuar esht' aý qe vjen, me émerin e Zotit. Perendí dhe Zot, permi dhene na u-çfaq. Shpetona, o i Bir' i Perendise, qe u-pagezove prej Joanit ne Jordán, né qe te kendojme Alilluia.

Ne vent te Hymnit Trishenjtor, kendohet:

Sa u-pagezuat me Zotin Krisht, u-veshte me Zotin Krisht, Alilluia.

SHKURTORJA, T. IV, EPIFANIS.

U-fanese me lavdí, ne tere boten, edhe drita jote sot, na u-shenua me çudí, pra te hymnojme

me kpetím: Ardhe u-duke, o drit' e paafrúarshme.

APOSTULLI

I bekuar esht' aý qe vjen me émerin e Zotit. Lavderójeni Zotin, se esht i mire.

Prej Letres se Palit per Titon.

Bir Tito, u-çfaq híri i Perendise, i cili i shpetój te gjithë njërezit, edhe i cili na mesón ta mohojme pabesine dhe dëshirat e kesáj bote, qe te rrojme ne keté jete me urtesí dhe me drejtesí dhe me bese te mire, dyke pritur shpresen e lumur dhe çfaqjen e lavdise se Perendise dhe Shpetimtarit tone Jesú Krisht, i cili e dha veten e tij per né, qe te na shpetonje nga te gjitha paudhësite, dhe te na spastronje per veten e tij si një popull te zgjedhur, i cili ka zell per vepra te mira. Dhe kur u-çfaq miresia dhe njeridashja e Perendise dhe Shpetimtarit tone, jo nga veprat e drejta, qe kemi bere né, po nga meshira e tij, na shpetój me banjen e perlindjes dhe perscritjes se Shpirtit te Shenjte, te cilin e derdhi mi né pasurisht me anen e Shpetimtarit tone Jesú Krisht, qe te drejtesóhemi me hirin e tij, dhe te béhemi trashëgimtare me shpresen e jetes se pasosur.

UNGJILLI PAS MATTHEUT

M' até kohe, vajti Jesúj prej Galilese ne Jordán, qe te pagezohej prej Joanit. Po aý e nda-

lonte, dhe i thoshte: "Une kam nevojë te pagezohem prej teje, dhe ti me vjen mua?" Dhe Jesúj iu-pergjéq: "Bej-e taní, se keshtú duhet t' i mbarojme te gjitha zakonet." Dhe ahere e beri. Dhe Jesúj, si u-pagezua, dolli menjhere prej ujit, edhe ja ku u-hap qelli, dhe e pá Shpirtin e Perendise, i cili i zbriti mi koke si pullúmp. Edhe u-degjua një ze prej qellit, i cili thoshte: "Ky esht im-Bir i dashur, i cili me ka pelqyer."

MADHËSHTIMI I MESHËS, T. II.

IX - B. O çudí pa funt e lindjes permi mendjen, Nus' e ndrícime dhe Nen' e lavdruar, Me te cilen múarme shpetím te plotte, Pra per mireberjen te doretrokasim Dhe kendime perhirimi te blatojme.

KUNGATORJA

U-çfaq hiri i Perendise, i cili i shpetój te gjithë njërezit.

7. *Shen Joani Pagezori.*

PERLGSHORJA E PAGEZORIT, T. II. MNIMI DHIQEU

I drejti kujtohet kudó me kenge, po ty t' arrín deshmini i Krishtit, o Parerendes dhe Pagezór. Se vertét u-tregove mé i nderúari i Proféteve, se u-vleresove per nderin te pagezósh te parelajmerúarin. Perandáj pra u-mundove per te verteten, dhe me gezím leçite ne mes te Ferrit,

se Krishti si njeri u-çfaq mi dhé, i cili ngre mekatin e botes, dhe na fal per gjithenjë meshiren e madhe.

THIRRTORET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Krishtin kur e shikój, Shen Jani ne Jordanin, me shpirtin po gezohej, dhe dora po i dridhej, dhe thosh lavdi me ty o Zot.

Vajte sot ne Jordán, te pá dhe tha Shen Jani: Jam robi ti je Zoti, si te te pagezónj pra, lavdi me ty o Perendi.

Unjesh o Zoti Krisht, perpara Shen Joanit, ne valat e Jordanit, drangonjte i dermove, i ngjalle gjithe njerezit.

LAVDI DHE TANI. Eja Shen Jan sherbé, per driten si kandili, per Dhénterrin si miku, per Fjalën si Profeti, i madhi Parerëndesi.

PASVARGJET, T. I, PANEFIMI.

Shen Jan Parrendes dhe Profét, i degjuar Pagezór, te lumerojme me bes' e mall, se ne Jordán te vjen, Krishti Perendia, edhe koken ty ta unj, dhe Pagezimin prej teje merr; pra nermjetó per né, tu dhuronje mekatárove, perdellimin, dhe ndjesen e fájeve.

Perpjete ne qiellin e pé, o Shen Jan o Pagezór, lavdín' e Atit te hýjeshme, Birin ner újerat, kur u-pagezua, edhe Shpirtin si pullúmp, qe ndriti boten me nje Trini, pra nermjetó per né, tu dhuro-

nje mekatárove, perdellimin, dhe ndjesen e fájeve.

Si more prej Zotit Jesú Krisht, hirin profetik Joán, na e tregove até qe ngre, fajet e njérsve, nga e tere bota, edhe i dhurove dy, dishepuj shoke per predikim, pra nermjetó per né, tu dhuronje mekatárove, perdellimin, dhe ndjesen e fájeve .

LAVDI DHE TANI, T. II. Krishtin e pagezón, Shen Jan o Parrendes, se ti e proklamove, si shqerre Perendie, shpetim te mekatárove.

NDENJESORET, T. I, TU LITHU SFRAJISTHENTOS

Kur lindi Jesú Krishti ne Judé prej Marise, dhe u-pagezua prej Joanit, ne lumin e Jordanit, ahete i zbriti Shpirti Shenjt, qe lártazi si nje pullúmp; perandáj Pagezori me ze te math, me Gngjajte po therriste: Lavdi fanesjes sate o Krisht, lavdi Mbretcrise sate, lavdi ekonomise sate, o Zot i meshírove.

LAVDI DHE TANI, *gjithajó.*

T. IV, EPIFANIS SIMERON

Kur te pá o Zoti Krisht, anes Jordanit, qe kerkonje Pagezím, Shen Jan Profeti Pagezór, po te therriste me ze te math: Ardhe u-duke, o drita e qiellit.

LAVDI DHE TANI, *gjithajó.*

Meqéneqe nuke ka Ungjill te Mengjezit, kendohet pa ze Psalmi 51, dhe menjehere:

SHKURTORJA, T. T. II.

Jordani u-droth nga pamja jote, dhe u-kthye prape i tmerruar o Krisht, edhe Shen Joani ish i trembur, kur po bente sherbesen shpirtore, edhe Engjejte çuditeshin per ngjarjen, edhe te gjithë te erresuarit pane agimin, dhe te lavderonin ty qe u-fanese, dhe i ndriçove te gjithë një-rezit.

SHTËPIA

Per Adamin te verbuar ne Edén, dolli dielli ne Bethlehém, edhe ia çeli syte, dhe ia lau me ujen e Jordanit, edhe lindi dita e paperenduar per te erresuarit. Taní nuk eshte nate mé, po dite e perjetme, se ardhe o Krisht edhe u-fanese, dhe i ndriçove te gjithë njërezit.

SINAKSARI

Me shtate te ketí múaji, kujtojme Shen Joanin, Profetin, Parcréndesin, dhe Pagezorin.

Me nermjetimet e Parcréndesit, o Krisht o Perendí, meshirona dhe shpetona. Amín.

Kendohen Zbritsoret e dyta (B) te Epifanise.

ZBRITCSORET, T. II, STIVI THALLASIS

I - B. Shkoj neper detin me kembe Israeli
Edhe ne sterén' arriu i palagur,
Po kaloresine armike Egjptiane
Zoti e permbyti ne nje varr prej valash
Me çudí dhe tmerr, me te djathten e
forte.

III - B. Né qe shpetuam nga leqet e armikut

Dhe nga thonj luancsh t' eger te ter-
buar,

Le ta çelim gojen dhe le te kendojme
Fjale melodie kenge lavderimi
Se na dha shpetim Zoti i pakursyer.

IV - B. I paqesuar prej nje zeri te shenjtc
Kendón Profeti perlindjen njerezore
Dhe i frymesuar po leçit me buje
Fjalën e panisme qe u-misherua
Dhe dermój perdhé poteren e armiqve.

V - B. Shpirt' i Shenjtc na ka lare prej çdo
helmi

Te armikut t' erret edhe te pabese,
Dhe na ka drejtuar n' udhen e vertete
Qe na shpie ne defrim te paafruar
Q' e fitójn' atá qe ka pajtuar Zoti.

VI - B. Bir te permallshim me ze te mallen-
gjyer

Ati prej qellit e prokllamój Jesune:
Ky tha eshte Biri i bashkepanisme,
Qe shkëlqén si diell permi njerezine,
Fjal' e Perendise qe u-misherua.

VII - B. Ne mes te lumit i povelój drangonjte
Aý qe Tre Djemat i shpetój prej furre
Dyke shuar zjarrin me vesen prej qellit,
Dhe keshtú mekatat edhe njollat tona
Shpirti Shenjt i lau me valat e Jordanit.

VIII - B. Tere krijesa çlirohet dhe gezohet,
Bij te drites béhemi né bijt' e nates,
Vetem po helmohet djall' i erresires;

Pra le ta bekojmë Shpetimtarin tone
Gjithë pópujtë që ishim të mjeruar.

IX - B. O çudí pa funt e lindjes permi mendjen,
Nus' e ndrìqime dhe Nen' e lavderuar,
Me të cilën múarme shpetím të plotte,
Pra për mireberjen të doretrokasim
Dhe kendime perhirimi të blatojmë.

MADHESHTIME E MËNGJJEZIT, T. II.

O shpirt madheshtoje, Zonjen e nderuar, mi
forcat Ëngjellore.

O shpirt madheshtoje, atë q' u-pagezua, në
lumin e Jordanit.

O shpirt madheshtoje, atë që prej Joanit, për
né u-pagezua.

O shpirt madheshtoje, atë që u-deshmua, prej
Atit lart nga qelli.

Sot Jesú Krishti unji, kryet nënë doren, e Shen
Joán Profetit.

Sot Shen Joán Profeti, e pagezón Jesunë, në
valat e Jordanit.

Sot i varrosi Krishti, mekatat njerezore, në va-
lat e Jordanit.

Sot po deshmohet Krishti, prej Atit lart nga
qelli, si Bir i tij i dashur.

LAVDI. O shpirt madheshtoje, Zotin Peren-
dine, Trinín' e lavderuar, të Shenjt' e të pandarë.

TANI. O shpirt madheshtoje, Nënë Virgje-
reshe, që na shpetójt nga Ferri.

IX - A. Asnjé gjuhë në botë s' të kendón dot

pas vlerës, dhe trubullohet mendja e gjith' Ën-
gjejtëve, për ty o Virgjereshe, po na prit me mi-
resí, pas besës që të kemi, se ti e di fort mirë, që
kemi mall për ty, dhe ty të madheshtojmë për-
herë, mprojtj' e besnikëve.

IX - B. O çudí pa funt e lindjes permi mendjen,
Nus' e ndrìqime dhe Nen' e lavderuar,
Me të cilën múarme shpetím të plotte,
Pra për mireberjen të doretrokasim
Dhe kendime perhirimi të blatojmë.

DERGIMSORËT, T. III, EPESKEPSATO

Si Profetin më të math, të lindur midis njëres-
ve, të leçiti Zoti Krisht, o Pagezór o Shen Joán;
se ti e prite në Jordán, dhe ti e pagezove, Jesunë
në újërát.

Na u-çfaq Shpetimtari Krisht, me të verte-
ten plot me hir, në valat e Jordanit sot, dhe gjit-
thë t' erresúarit, dhe të fjéturit i zgjoj, se ardhí
dhe na ndriti, si drita e díellit.

LAVDERIMET, T. I.

Dritë prej dritë, i ndriti botes Krishti, Peren-
dia yne.

Si të të nderojmë pas vlerës, në sherbetoret ty
Zotin? Se ti na perserite në újërát.

U-pagezove në Jordán o Shpetimtár, dhe i
shenjtërove újërát, sherbetori të vuri doren mi
koke, dhe i sherove vajtjet e botes. Misteri i eko-

nomisë sate është i math, o Zot njeridashes lavdimit me ty.

Drita e vertete na u-fanës, edhe i ndriti te gjithë. Krishti u-pagezua për në, dhe na i spastrói mekatat e shpirtit. Ngjarja është e dheshme, po kuptimi është qellor, se zbriti në ujën dhe na ngriti me Perëndinë. Veprat e tua janë te çuditëme, o Zot lavdimit me ty.

Aj që e peshjtëll qellin me reçe, aj që ngre mekatin e botës, edhe deshmohet që lartazi prej Shpirtit Shenjt, edhe proklamohet prej Atit Bir i vetemlindur. Ati le t' i thërresim te gjithë: Ti që u-fanese dhe na shpetove, o Krisht o Perëndia ynë lavdimit me ty.

LAVDI, T. T. II. Engjëll prej beronjes ardhë o Pagezori, banove në shkretërinë që prej foshnjërisë, dhe u-tregove më i madhi i Profetëve, se ti u-vlerësove ta pagezosh, atë që lajmëruan te tjeret, edhe ti e dëgjove zerin e Atit, që e proklamoi Bir te dashur, edhe ti e pë Shpirtin Shenjt, që i zbriti mi koke si pullump. Ti pra më i lartë i Profetëve, nermjetë pa pushuar për në, që po kremtojmë besërisht kujtimin tënt.

TANI, T. II. Sot Krishti vajti në Jordani që te pagezohet. Sot Joani ia ve doren mi koke Zotit. Forcat Engjëllore u-çuditë, kur e panë këtë mister te habijm. Deti e pë edhe iku, Jordani u-kthye prapë. Edhe në te ndriçuarit po thërresim: Lavdimit Perëndisë që u-fanës, edhe u-duk mi dhënë, dhe e ndriti botën.

HYRTORJA

I bekuar është aj që vjen me ëmërin e Zotit. Perëndi dhe Zot, përmi dhënë na u-çfaq. Shpetona o i Bir' i Perëndisë, që u-pagezove prej Joanit në Jordani, në që te kendojmë, Alilluia.

Ne vent te Hymnit Trishenjtör, kendohet:

Sa u-pagezuat me Zotin Krisht, u-veshte me Zotin Krisht, Alilluia.

SHKURTORJA, T. IV, EPEFANIS.

U-fanese me lavdimit, në tërë botën, edhe drita jote sot, na u-shënuar me çuditë, pra te hymnojmë me kuptim: Ardhe u-dukë, o drit' e paafruarshme.

APOSTULLI

I drejti do te ngazellohet me Zotin. Dëgjoma zerin, o Perëndi.

Prej Akteve te Apostujve.

M' atë dite, kur ndodhej Apollói në Korintë, Pali shkoj nga bregu i detit, edhe ardhi në Efesë, edhe gjeti disa dishepuj, edhe i pyeti: "A e muate Shpirtin e Shenjtë, kur besuat?" Edhe atë iu-përgjete: "As e kemi dëgjuar që ka një Shpirt te Shenjtë." Dhe aj i pyeti përsëri: "Atehere si jini pagezuar?" Dhe atë iu-përgjete: "Me pagezimin e Joanit." Edhe Pali u tha: "Joani pagezonte me pagezimin e pendimit, edhe i thoshte pëpullit te besojnë atë, i cili vinte pas,

domethenc Krishtin Jesú.” Edhe kur i dëgjjuan ketó, u-pagezuan me émerin e Zotit Jesú. Edhe Pali ua vuri dúarte mi koken, edhe ardhi Shpirti i Shenjte mi atá, edhe flisnin gjuhe te ndryshme, edhe profetesonin. Edhe ketá ishin gjitheséj nja dymbëdhjete veta. Edhe shkonte ne sinagoje, edhe fliste hapur nja tre muaj, edhe bisedonte, edhe predikonte mi Mbretërine e Perendise.

UNGJILLI PAS JOANIT

M’ até kohe, Joani e pá Jesúne, qe po i vinte, dhe tha: “Ja qengji i Perendise, i cili ngre mekatin e botes. Ky esht aý, per te cilin ju thashe: Pas meje vjen aý, qe eshte perpara meje, se aý ka qene mé pare se une. Edhe une nuk e njihnja, po perandáj kam ardhur, edhe kam pagezuar me uje, qe tja çfaq pópullit te Israelit.” Edhe Joani desh mój, edhe tha: “E pashe Shpirtin e Shenjte, qe i zbriti si pullúmp prej qellit, edhe i qendrój mi koke. Edhe une nuk e njihnja, po aý, qe me ka derguar te pagezónj me uje, aý me tha: Aý, mi te cilin do te shikósh qe do te zbrese Shpirti i Shenjte, dhe do t’ i qendronje mi koke, aý eshte qe do te pagezonje me Shpirtin e Shenjte. Dhe une e pashe, dhe desh mova, dhe ky esht i Biri i Perendise.”

MADHËSHTIMI I MESHËS, T. II.

Sot Shen Joán Profeti, e pagezón Jesune, ne valat e Jordanit.

O çudí pa funt e lindjes permi mendjen,

Nus’ e ndrícime dhe Nen’ e lavdëruar,
Me te cilen múarme shpetím te plotte;
Pra per mireberjen te doretrokasim,
Dhe kendime perhirimi te blatojme.

KUNGARORJA

I drejti do te kujtohet per jete.

E DIELA PAS EPIFANISE

(Qe me 7-14 te Jenarit)

Kendohen Troparet e Tingellit qe rastís bashke me ató te Epifanise.

ZBRITËSORET, T. II, STIVI THALLASIS

Kendohen Zbratesoret e dyta (B) te Epifanise.

I - B. Shkoj neper detin me kembe Israeli
Edhe ne sterén’ arriu i palagur,
Po kaloresine armike Egiptiane
Zoti e permbyti ne nje varr prej valash
Me çudí dhe tmerr, me te djathten e
forte.

III - B. Né qe shpetuam nga leqet e armikut
Dhe nga thonj luanesh t’ eger te ter-
buar,
Le ta çelim gojen dhe le te kendojme
Fjale melodie kenge lavderimi
Se na dha shpetím Zoti i pakursyer.

IV - B. I paqesuar prej nje zeri te shenjte
Kendón Profeti perlindjen njerezore
Dhe i frymesuar po leçit me buje
Fjalën e panisme qe u-misherua

Dhe dërmój perdhé poteren e armiqve.

V-B. Shpirt' i Shenjte na ka lare prej çdo helmi

Te armikut t' erret edhe te pabese,
Dhe na ka drejtuar n' udhen e vertete
Qe na shpie ne defrim te paafruar
Q' e fitójn' atá qe ka pajtuar Zoti.

VI-B. Bir te permallshim me ze te mallen-
gjyer

Ati prej qellit e proklamój Jesune:
Ky tha eshte Biri i bashkepanisme,
Qe shkelqén si diell permi njerezine,
Fjal' e Perendise qe u-misherua.

VII-B. Ne mes te lumit i pavelój drangonjte
Aý qe Tre Djemat i shpetój prej furre
Dyke shuar zjarrin me vesen prej qellit,
Dhe keshtú mekatat edhe njollat tona
Shpirti Shenjt i lau me valat e Jordanit.

VIII-B. Tere krijesa çlirohet dhe gezohet,
Bij te drites béhemi né bijt' e nates,
Vetem po helmohet djall' i erresires;
Pra le ta bekojme Shpetimtarin tone
Gjithe pópujte qe ishim te mjeruar.

IX-B. O çudí pa funt e lindjes permi mendjen,
Nus' e ndrícime dhe Nen' e lavdëruar,
Me te cilen múarme shpetim te plotte,
Pra per mireberjen te doretrokasim
Dhe kendime perhirimi te blatojme.

SHKURTORJA, T. IV, EPEFANIS.

U-fanese me lavdí, ne tere boten, edhe drita

jote sot, na u-shenua me çudí, pra te hymnojme
me kupetím: Ardhe u-duce, o drit' e paafrú-
arshme.

APOSTULLI

Arthte meshira jote mi né, o Zot. Ngazelló-
huni me Zotin, o te drejte.

Prej Letres se Palit per Efesianet.

Vellezer, hiri i eshte dhene sicilitdó prej nesh
pas mases se dhurates se Krishtit. Përandáj tho-
te: "Si u-ngjit lart, e roberój roberine, dhe u dha
porrosira njéresve. Edhe posa u-ngjit, ajó do-
methene qe kishte zbritur mé pare ner anet mé
te poshtme te dheut. Edhe posa kishte zbritur,
ajó domethene qe u-ngjit mé pastáj permi qellin
qe t' i mbaronte te gjitha. Edhe ca i beri Apos-
tuj, ca Profete, ca Ungjillorc, ca Barínj dhe Me-
sonjes per stervitjen e Shenjtóreve, per vepren e
sherbases, per ndertimin e trupit te Krishtit, gjer
sa te arrijme ne njesine e beses dhe ne njohjen
e Birit te Perendise dhe ne burrerine e plotte dhe
ne masen e moshes se plotesise se Krishtit.

UNGJILLI PAS MATTHEUT

M' até kohë, Jesúj, kur degjój se Joani ishte
arestuar, vajti ne Galilé, dhe shkoj nga Naza-
reti, dhe u-vendós ne Kapernaúm, qe eshte anes
detit ne qarkun e Zabullonit edhe Nefthalimit,
qe te mbushen fjalct e thena prej Profetit Isaia:
"Toke e Zabullonit edhe toke e Nefthalimit anes

detit, pertëj Jordanit, Galilé e Gjentëve; pópulli, qe ishte i erret, pá nje drite te madhe, edhe atyre, qe ishin te vdekur, u lindi díelli.” Qe atehere Jesúj nisi te leçite dhe te thote: “Pendóhuni, se u-afrua Mbreteria e qellit.”

8. *Domnika, Nena jone Oshenare; Gjergji Hozeviti, Ati yne Oshenár.*

PERLESHORJA E SHËN DOMNIKËS,
T. IV, KATEPLLAJI IOSIF

Shqerra jote o Jesúj, me ze te math po te the-rrét: Dhenter ty te desherónj, dhe nat' e dite te kerkónj, dhe kryqesohem dhe varrosem tok me Pagezimin; edhe vuanj tok me ty, qe te gezohem tok me ty, edhe vdes per emrin tent, qe tok me ty te rronj ne qell; po si nje fli te shenjte prit-me mua qe per ty sakrifikohem. Degjona lutjet, edhe shpëtoji, shpirtet tona prej vdekjes.

PERLESHORJA E GJERGJIT HOZEVITIT,
T. T. IV, EN SI PATER AKRIVOS

Ti o Ate pikerisht, u-tregove shembell e Zotit, se e more Kryqin tent, dhe pasove Zotin Krisht, dhe vepra çfaqë per mesím, qe te çkujdësemi per trup, se shkon me nxitím, dhe te kujdësemi per shpirt, se është i pavdekur; pra shpirti yt po gezohet tok me Engjëjtc, o Ate Gjergj i lumur lavdí me ty.

9. *Poliefti, Deshmori i Shenjte.*

10. *Grigori, Ati yne i Shenjte, peshkopi i Nysses; Dometiani, Ati yne Oshenár, peshkopi i Melitines.*

PERLESHORJA E GRIGORIT TE NYSSËS,
T. IV.

O Perëndí i Aterve, qe na sillesh gjithënjé, me miresí dhe butesí, mos e kursé perdellimin tent per né; me lutjet e Aterve tane, qeveris-e jeten tone me paqe.

11. *Shen Theodosi.*

PERLESHORJA E SHËN THEODOSIT,
T. T. IV, TES TON DHAKRION SU

Me lote derdhur si reké, shkretetiren e that' e vadite per lerím, dhe me vajtím dhe psherctím, gjer nje qint here peme mblodhe per çdo mundím; u-çfaqë pra si yll, dhe e ndriçove boten me çdo çudí, Shen Theodós o Ati yne Oshenár, lutju Zotit Krisht Perëndí, te shpëtohen shpirtet tona.

THIRRTORET, T. T. I, KHERIS ASKITIKON

Lum ti o Theodós Ashketí, thesár dhe arke, e shkelqyer e vójtjeve, se Kryqin mi sup e ngrite, dhe Zotit Krisht pas i ré, dhe sakrifikove veten pa kursím; deshirat e póshtera, trupesore perdhé i shkel, dhe me virtuta, shpirtin tent e stolís e ngre, dhe me zell qellór ne Parajsen e larteson. Pra sot ketú po mblídhemi, kremtojme kujtimin tent, o Theodós i degjuar dhe te perlotur te lútemi; na mpro prane Zotit, dhe te gjithëve dhu-rona, meshire dhe shpëtim.

Ndrit si thengjill i ndezur ne qell, i frymesuar si Profetet prej Shpirtit Shenjt, ne boten fi-

tove fame, dhe predikove kudó, fjalet e Ungjillit plot me ngazellím; dhe driten që s' perëndón, e përhapë kudó mi dhé, dhe shkretëtiren, e vesove që lártazi, dhe thëngjijt' e saj i flladite çuditërisht. Pra Kryetari Zoti Krisht, kuroren e múndjeve, të ka dhuruar o Atë, edhe Parajsen e Gngjçjve; përpara tij mprona, dhe të gjithëve dhurona, meshirë dhe shpëtím.

Shkallë që lart në qellin arrín, o At i Shenjtë, na u-çfaqë mi dhënë ti, u-ngrite përpara Zotit, dhe me Jesunë po flet, Oshenár i lumur, ashketí me nam; dhe dritën e qíellit, dhe t' Ungjillit të Zotit Krisht, e predikove, nga tribunat e Kísheve, edhe njërczit i ndriçove me bes' e mall; pra në Parajsen je taní, dhe lutësh për gjithë né, që ta kremtojmë kujtimin, përunjësisht dhe të lútemi; na mëpro përpara Zotit, dhe të gjithëve dhurona, meshirë dhe shpëtím.

LAVDI, T. II. O Theodós me nam, virtuta ke lëruar, çudira ke punuar, me lutje pra dhurona, Parajsen e Senjtóreve.

TANI. Çdo shpresë me ty e varr, Marí o Hyjlíndese, Nen' e Zotit Krisht, ti më ruaj përher' e ti më mëpro.

PASVARGJET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Çfaqësh në vogelí, i zgjédhuri i Zotit, dhe en' e Shenjteruar, o At i frymesuar, prej Krishtit dhe prej Shpirtit Shenjt.

Kryqin në dor' e mban, o Ashketí i lumur, dhe

djajtë dhe demonet, fantazmat dhe kuçedrat, o At' i çkaterrove krejt.

Djajtë i shtype krejt, dhe faqebardhë dolle, me Kryqin dhe me Krishtin, edhe u-lavderove, o Atë Oshenár me nam.

LAVDI DHE TANI, T. II. Pate keq dashurí, për bukurít' e qellit, dhe gjárperin e shkele, dhe shkove në Parajsen, dhe lutësh gjithënjé për né.

NDËNJËSORE, T. I, TON TAFON SU

Jetovë shpresërisht, përmi dhënë o Atë, i pastër dhe pa cen, si i zgjedhur i Zotit, si dritë udhëheqëse, e të gjithë besnikëve, pra të lútemi, të nermjetósh për Krishtit, të shpëtóhemi, o Theodós i degjuar, o Atë lavdí me ty.

LAVDI DHE TANI. Si nënë të Jesújt, që të gjithë të njohim, o Zonjë Shen Marí, Virgjëreshë pas lindjes, perikim pra më ty më mall, si e mirë që je për né; ty të kemi pra, né mëkatarët si mëprojtje, prej rezíkeve, dhe shpëtimtare në ngasjet, o Nënë Hyjlíndese.

T. T. IV, TIN SOFIAN

More Kryqin e Zotit tonë Jesú, edhe pas e vazhdovë gjer në mbarím, dhe prapë s' u-kthëve më, në qytetet e njëresve, me përmbajtje dhe vajtje, pësimet i vrave krejt, dhe e bërë trupin një tempull të Shpirtit Shenjt; more pra dhurata, për mundimet e renda, lengatat të na shërósh, dhe demonet të na i dbosh, Theodós Oshe-

nár me nam, lutju Krishtit Perëndí, të na dhuronje ndjesen e mekátave, neve që sot e kremtojmë, beserísht kujtimin tent.

LAVDI DHE TANI. Shpirtin tim të perunjur o Shen Marí, që në shqotën e jetës brenda në det, po rrihet prej ércve, dhe perpiqet prej válave, edhe nga barr' e mekatit, po mbytet prej újeve, edhe në funt të Ferrit po kridhet taní me vrap; eja Virgjreshë, dhe me lutjet e nxehta, shpëto më dhe shpërmë shpejt, në limán dhe në qetesí, se me besë po të therrés: Lutu-i Birit Jesú Krisht, të na dhuronje ndjesen e mekátave, se më ty kemi shpërc, gjithë të pavýerit.

T. T. IV, TIN SOFIAN

Çdo të mirë të jetës, prapa e lé, edhe ndónese kishe trupin mi dhé, u-bere si Gngjejtë, edhe rronje në qíellin; se për çudí i shove, pesimet e trupit tent, edhe shok i Trinisë, u-çfaqë me lumëri; pra sherón semundjet, dhe lengatat e trupit, dhe dbon çdo demón të lik, me një fjal' e një porrosí, Theodós Oshenár me nam, lutju Krishtit Perëndí, të na dhuronje ndjesen e mekátave, neve që sot e kremtojmë, beserísht kujtimin tent.

SHKALLESA KREMTORE

Që prej djalerisë, shumë pasione më leftojnë, po ti perkrah-më dhe shpëto më, o Shpëtimtari im.

Ju që urreni Sionen, do të turperóheni prej

Zotit, dhe do të físhkeni si bari në zjarr.

LAVDI. Me anën e Shpirtit të Shenjtë, merr jetë çdo shpirt, dhe lartësohet në paqesí, dhe ndriçohet prej njesisë Trinisë mistikerísht.

TANI. Me anën e Shpirtit të Shenjtë, rjedhin burimet e hirit, edhe vaditin tërc kriesen për jetelindje.

PARCVARGU. Vdekja e Oshenarit është e nderuar përpara Zotit.

UNGJILLI I MËNGJJEZIT PAS MATTHEUT

Zoti u tha Dishépujve: Të gjitha më i ka dorëzuar im-Atë; dhe asnjë nuk e njeh Birin përveç Atit; edhe asnjë nuk e njeh Atin përveç Birit edhe atí, të cilit Biri do tja zbulonje. Ejani tek unë të gjithë të lódhurit edhe të ngarkúarit, edhe unë do tju përç. Ngréreni zgjedhën time më veten tuaj, dhe mësoni prej meje që jam i butë dhe i perunjur nga zemra, dhe do të gjëni përçje në shpirtin. Se zgjedha ime është e lehtë.

Psalmi 51 pa ze.

LAVDI. Me nermjetimet o Oshenarit, o mëshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

TANI. Me nermjetimet e Hyjlíndesës, o mëshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

Meshirome, o Perëndí meshireplót, edhe shúaji paudhesít' e mia.

O Theodós me nam, virtuta ke leruar, çudira

ke punuar, me lutje pra dhurona, Parajsen e Shenjtóreve.

SHKURTORJA, T. T. IV, TI IPERMAKHO

Prej foshnjërisë, u-blatove si kurbán me mall, dhe me virtutat, shkrepëtive Theodós me nam, për atë që të bekóje përpara se të linte. Dhe u-çfaqë, si i par' i Oshenárëve, dhe si kollonizatór i shkretëtirave; të therrës pra sot: Lum ti o Ashketí i Math.

SHTËPIA

Dësherove urtesinë që prej foshnjërisë, o Theodós, At' i Shenjtë Oshenár, dhe u-ndave prej botes dhe u-ngjite në qell, ku fitove kuroren e pafishkur të Oshenárëve, dhe u-lavderove prej Krishtit në Parajsen e Shenjtóreve. Përandáj, pra, të thërresim sot: Lum ti o Ashketí i Math.

SINAKSARI

Me njëmbëdhjetë të ketí múaji, kujtojmë Shen Theodosin, Atin tonë Oshenár, Kenobiarkun dhe Udhehéqesin e Shkretëtirës.

Gjithë sot, kujtojmë mbledhjen e të Dhjetë Mijë Engjëjve në Kishën e Shen Anastasisë në Domník.

Gjithë sot, kujtojmë Shen Stefanin e Plakidí-nave, Shen Theodorin dhe Arkimandritin Agáp.

Gjithë sot, Mairi, Dëshmori i Shenjtë, e mbaróje jetën e munduar.

Gjithë sot, Vitali, Ati ynë Oshenár, e mbaróje jetën me paqe.

Me nermjetimet e tyre, o Perendí, meshirona. Amín.

ZBRITËSORET, T. II, STIVI THALLASIS

Këndohen Zbritesoret e dyta (B) të Epifanisë.

I - B. Shkoj nëpër detin me kembë Israeli
Edhe në sterén' arriu i palagur,
Po kaloresinë armike Egjiptiane
Zoti e përmbysi në një varr prej valash
Me çudí dhe tmerr, me të djathten e
forte.

III - B. Né që shpetuam nga leqet e armikut
Dhe nga thonj luanësh t' eger të ter-
buar,
Le të çelim gojën dhe le të këndojmë
Fjalë melodie kenge lavderimi
Se na dha shpëtím Zoti i pakursyer.

IV - B. I paqësuar prej një zeri të shenjtë
Këndón Profeti për lindjen njëzore
Dhe i frymësuar po leçit me bujë
Fjalën e panisme që u-mishërua
Dhe dermóje përdhé potëren e armiqve.

V - B. Shpirt' i Shenjtë na ka lare prej çdo
helmi
Të armikut t' erret edhe të pabesë,
Dhe na ka drejtuar n' udhën e vertetë
Që na shpëtoi në defrím të paafuar
Q' e fitóje atá që ka pajtuar Zoti.

VI - B. Bir të permallshim me zë të mallen-
gjer

Ati prej qellit e proklamóje Jesunë:
Ky tha është Biri i bashkepanismë,
Që shkëlqën si diell përmi njerezinë,
Fjal' e Perëndisë që u-mishërua.

VII - B. Në mes të lumit i përvëlóje drangonjte
Aý që Tre Djemat i shpëtóje prej furrës
Dyke shuar zjarrin me vesën prej qellit,
Dhe kështú mekatat edhe njollat tona
Shpirti Shenjt i lau me valat e Jordanit.

VIII - B. Tërë krijesa çlirohet dhe gezohet,
Bij të drites bëhemi në bijt' e natës,
Vetëm po helmohet djall' i erresirës;
Pra le ta bekojmë Shpëtimtarin tonë
Gjithë pópujtë që ishim të mjeruar.

IX - B. O çudí pa funt e lindjes përmi mendjen,
Nus' e ndrícime dhe Nën' e lavdëruar,
Me të cilën múarme shpëtím të plotë,
Pra për mireberjen të dorëtrokasim
Dhe kendime perhirimi të blatojmë.

DERGIMGSORET, T. III, FOS ANALIOTON

O shkretëtirë gezohu, dhe lulezó si zambaku,
se t' i ka shtuar pallatet, dhe bijtë Shen Theodosi,
dhe ti o vend i Sirisë, këcë dhe ngazellohu, në di-
ten e sotme.

Ti o kështjéll' e florinjte, me dymbëdhjetë
fortesa, o fron që ndrit posi dielli, ku mbreti rri

me Shenjtoret, ti o çudí që s' ke kufí, o Nënë Vir-
gjereshë, që Zotin na linde.

LAVDERIMET, T. I, TON URANION

Ti që përbufe të mirat e këtí shékulli, dhe pa-
te mall për qellin edhe për shkretëtirën, o Atë
Theodós të gjithë na fton, ta kremtojmë kujti-
min tënt, se pranë Zotit përherë po nermjetón,
për shpëtimin e besnikëve.

Në botë s' deshe gjë tjetër përveç virtútave,
me të e lavdërove përmi dhënë sa rrojte, Jesunë
Shpëtimtarin me ngazellím, dhe fitovë lavdí në
qell, edhe sherime lengatash po na burón, Theo-
dós Oshenár me nam.

I mir' i matur i butë edhe i embël fort, ke qen'
o At i Shenjte, përmi çdo njerí tjetër, dhe tem-
pull shpirtëror i Zotit Jesú, u-tregovë këtú mi
dhé, edhe dhurata shëronjëse po u fal, pasurísht
adhurónjesve.

LAVDI, T. II. O Theodós me nam, në botën u-
degjovë, demonet i dermove, dhe Çngjëjt' i arri-
ve, dhe shpirtet tona i shpëtón.

TANI. Zonjë Hyjlíndese, me lutje pranë Birit,
çlirona nga mekatat, shpëtona dhe dhurona, Pa-
rajsën e Shenjtóreve.

SHKURTORJA, T. IV, EPEFANIS

U-fanese me lavdí, në tërë botën, edhe drita
jotë sot, na u-shënuar me çudí, pra të hymnojmë

me kupetím: Ardhe u-duke, o drit' e paafrú-arshme.

APOSTULLI

Vdekja e Oshenarit është e nderuar përpara Zotit. Si do tja çpaguejme Zotit të gjitha të mirat?

Prej Letres së Palit për Hebrenjtë.

Vellezer, bindjuni kréreve tuaj, dhe degjëjini; se atá vigjellojnë për shpirtet túaja, meqéneqë do të japin fjale për këtë gjë; se atçhere do të bëjnë me gezím dhe jo dyke psheretit; edhe kjo nuk është e dobishme për ju. Fáluni për né, se jemi të bindur që kemi ndergjëgjie të kthjellët, se jemi përpjekur të sillemi mirë me të gjithë; dhe më tepër ju lutem ta bëni këtë gjë, që të vendosim më shpejt pranë jush. Edhe Perendia i paqes, i cili e ngriti së vdekuresh barinë e math të dhëve, Zotin tonë Jesús, me gjakun e dhjates së perjetme, ju stervitë për çdo veper të mirë, që ta mbaroni dëshirën e tij, dhe ju bëftë si ta gjenjë të pelqyer me anën e Jesús Krishtit, i cili pastë lavdí në jetet e jéteve. Amín.

UNGGJILLI PAS LUKAJT

M' atë kohë, Jesús qëndrój në një fushe me grupin e Dishépujve dhe me një shumicë të madhe prej pópulli nga e tërc Judea dhe nga Jerusalemi dhe nga anëdeti i Tyres edhe Sidones, të cilët kishin ardhur që ta degjonin dhe të shëröheshin prej sëmundjeve dhe demónëve, edhe bë-

heshin të shendoshe. Dhe pópulli i tërc dëshnin ta preknin; se një forcë dilte prej atí, edhe i shëronte të gjithë. Dhe Jesús i ngriti sytë mi Dishépujtë, dhe u tha: "Lum' ju të vërferit, se Mbretëria e Perëndisë është júaja; lum' ju që jini taní të urret, se do të ngínjeni; lum' ju që qani taní, se do të qeshni; lum' ju, kur njërezit do tju urrejnë, dhe do tju çkisherojnë, dhe do tju përqeshin, dhe do tju nxijne emrin për të Birin e njeriut. Gezóhuni atë ditë, dhe ngazellóhuni, se roga juaj do të jetë e madhe në qell."

KUNGATORJA

I drejti do të kujtohet për jetë.

12. *Tatiana, Deshmorja e Shenjte.*

13. *Hermili dhe Stratoniku, Deshmoret e Shenjte.*

14. *Aterit tane Oshenare, që u-vrane në Siná dhe Raitho.*

15. *Pali Thebani dhe Joani Kaliviti, Aterit tane Oshenare.*

PERLGSHORJA E PALIT THEBANIT, T. IV, EPEFANIS SIMERON

Le ta lusim me lavdí, yllin e qellit, se shkelqeu me çudí; le t' i thërresim besçísht, Palit të Thebes me brohorí: O Murk i Shenjte, gezimi i Zotit Krisht.

PERLGSHORJA E JOANIT KALIVITIT, T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Per Zotin ke patur mall, në foshnjëri Shen Jo-

án, dhe boten e shkret' e le, dhe çdo gezím dhe defrím, dhe rrojte si Ashketí; pra mun perpara portes, prinderore kaliven, bere dhe shenjterove, gjithë djajt' i dermove; pra Zoti Jesú o Shen Joán, pas vleres te lavderój.

16. *Adhurimi i Vargonjve te Shen Pjetrit, Apostullit te lavderuar.*

PERLGSHORJA E SHEN PJETRIT, T. II

Pa ikur nga Roma, udhetove afer nesh, me vargónjt' e çemuar qe ke mbajtur, o Parerfrones i Apostujve; pra me besë i adhurojme dhe te lútemi: Nermjetó prane Zotit, te na dhuronje per-dellimin e math.

17. *Shen Andoni i Math, Ati yne Oshenár dhe Hyj-prures.*

PERLGSHORJA E SHEN ANDONIT, T. IV

Imitove Shent Elline pas menyrave, dhe pasove ne ruget e drejta Pareréndesin, Ate Andón i Math, dhe banove ne shkretetire, dhe mprove boten me uratat e tua. Pra lutju Krishtit Perendí, te shpetohen shpirtet tona.

THIRRTORET, T. T. I, KHERIS ASKITIKON

Lum ti o Ashketí Shen Andón, thesár dhe arke, e shkelqyer e vójtjeve, se Kryqin mi sup e ngrite, dhe Zotit Krisht pas i ré, dhe sakrifikove veten pa kursím; deshirat e póshtera, trupesore perdhé i shkel, dhe me virtuta, shpirtin tent e stolís e ngre, dhe me zell qellór ne Paraj-

sen e larteson. Pra sot ketú po mblídhemi, kremtojme kujtimin tent, o Shen Andón i degjuar, dhe te perlotur te lútemi; na mpro prane Zotit, dhe te gjítheve dhurona, meshire dhe shpetím.

Ndrit si thengjill i ndezur ne qell, i frymesuar si Profetet prej Shpirtit Shenjt, ne boten fitove fame, dhe predikove kudó, fjalët e Ungjillit, plot me ngazellím; dhe driten qe s' perendón, e perhape kudó mi dhé, dhe shkretetiren e vesove qe lartazi, dhe thengjijt' e saj, i flladite çuditerisht. Pra Kryetari Zoti Krisht, kuroren e múndjeve, te ka dhuruar o Ate, edhe Parajsen e Engjejeve; perpara tij mprona, dhe te gjítheve dhurona, meshire dhe shpetím.

Shkalle qe lart ne qellin arrín, o At i Shenjte, na u-çfaqë mi dhene ti, u-ngrite perpara Zotit, dhe me Jesune po flet, Oshenár i lumur, Ashketí me nam; dhe driten e qiellit, dhe t' Ungjillit te Zotit Krisht, e predikove, nga tribunat e Kísheve, edhe njérezit i ndriçove me bes' e mall; pra ne Parajsen je taní, dhe lutesh per gjithë né, qe ta kremtojme kujtimin, perunjesisht dhe te lútemi; na mpro prane Zotit, dhe te gjítheve dhurona, meshire dhe shpetím.

LAVDI, T. II. O Shen Andón me nam, virtuta ke leruar, çudira ke punuar, me lutje pra dhurona, Parajsen e Shenjtóreve.

TANI. Çdo shprese me ty e varr, Marí o Hyj-

lindese, Nen' e Zotit Krisht, ti me ruaj përhér' e ti me mpro.

PASVARGJET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Çfaqesh në vogël, i zgjédhuri i Zotit, dhe en' e shenjtëruar, o At i frymësuar, prej Krishtit dhe prej Shpirtit Shenjt.

Kryqin në dor' e mban, o Ashketí i lumur, dhe djajtë dhe demonet, fantazmat dhe kuçedrat, o At' i çkaterrove krejt.

Djajtë i shtype krejt, dhe faqebardhë dolle, me Kryqin dhe me Krishtin, edhe u-lavderove, o Atë Oshenár me nam.

LAVDI DHE TANI, T. II. Pate keq dashurí, për bukurít' e qellit, dhe gjárperin e shkele, dhe shkove në Parajsen, dhe lutesh gjithënjé për né.

NDËNJËSORE, T. I, TON TAFON SU

Jetovë shpresërisht, përmi dhënë o Atë, i pastër dhe pa cen, si i zgjedhur i Zotit, si dritë udhëhëqese, e të gjithë besnikëve, pra të lútemi, të nermjetósh pranë Krishtit, të shpëtóhemi, o Shen Andón i degjuar, o Atë lavdí me ty.

LAVDI DHE TANI. Si nënë të Jesúsit, që të gjithë të njohim, o Zonjë Shen Marí, Virgjëreshë pas lindjes, perikim pra me ty me mall, si e mirë që je për né; ty të kemi pra, né mekatarët si mprojtje, prej rezíkeve, dhe shpëtimtare në ngasjet, o Nënë Hyjlíndese.

T. T. IV, TIN SOFIAN

More Kryqin e Zotit tonë Jesús, edhe pas e vazhdovë gjer në mbarím, dhe prapë s' u-kthevë më, në qytetet e njëresve, me përmbajtje dhe vajtje, pesimet i vravë krejt, dhe e bërë trupin të një tempulli të Shpirtit Shenjt; more pra dhurata, për mundimet e rënda, lëngatat të na shërósh, dhe demonet të na i dbosh, Shen Andón Oshenár me nam, lutju Krishtit Perendí, të na dhuronjë ndjesën e mekátavë, nëvë që sot e kremtojmë, besërisht kujtimin tënt.

LAVDI DHE TANI. Shpirtin tim të përunjur o Shen Marí, që në shqotën e jetës brenda në det, po rrihet prej ércëve, dhe përpiqet prej vólavë, edhe nga barr' e mekatit, po mbytet prej újvë, edhe në funt të Ferrit, po kridhet taní me vrap; eja Virgjëreshë, dhe me lutjet e nxehta, shpëto më dhe shpërmë shpejt, në limán dhe në qetësi, se me besë po të therrës: Lutu-i Birit Jesús Krisht, të na dhuronjë ndjesën e mekátavë, se me ty kemi shpresë, gjithë të pavýerit.

T. T. IV, TIN SOFIAN

Çdo të mirë të jetës, prapa e lé, edhe ndónesë kishe trupin mi dhé, u-bërë si Çngjëjtë, edhe rronjë në qíellin; se për çudí i shovë, pesimet e trupit tënt, edhe shok i Trinisë, u-çfaqë me lumërí; pra shërón sëmundjet, dhe lëngatat e trupit, dhe dbon çdo demón të lik, me një fjal' e një porrosí, Shen Andón Oshenár me nam, lutju

Krishtit Perendí, te na dhuronje ndjesen e mekátave, neve qe sot e kremtojme, beserisht kujtimin tent.

LAVDI DHE TANI. Ti o porte qellore o Shen Marí, ti o mali i shenjte plot me shkelqím, o re udhchécqese, ti o shkalla e qëllshime, ti o Parájs' e méndeshme, per Even shpetónjese, ti o thesár i botës, i shtrenjte i çmúarshim; ti o Nen' e Shenjte, ti shpctimin na solle, nga fajet e prinderve, dhe mallkimet e gjýsherve. Perandáj te therresim: Nermjetó prane Birit tent, te na dhuronje ndjesen e mekátave, neve qe sot e kremtojme, beserisht kujtimin tent.

SHKALLESA KREMTORE, T. IV.

Qe prej djalerise, shume pasione me leftojne, po ti perkrah-me dhe shpetome, o Shpctimtarim.

Ju qe urreni Sionen, do te turperóheni prej Zotit, dhe do te físhkeni si bari ne zjarr.

LAVDI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, merr jete çdo shpirt, dhe larteshohet ne paqesi, dhe ndriçohet prej njesise Trinisore mistikerisht.

TANI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, rjedhin burimet e hirit, dhe vaditin tere kriesen per jetelindje.

PARCVARGU. Vdekja e Oshenarit esht e nderuar perpara Zotit.

UNGGJILLI I MENGJEZIT PAS MATTHEUT

Zoti u tha Dishépujve: Te gjitha m' i ka dore-

zuar im-Atë; dhe asnjé nuk e njeh Birin pervéc Atit; edhe asnjé nuk e njeh Atin pervéc Birit edhe atí, te cilit Biri do tja zbulonje. Ejani tek une te gjithë te lódhurit edhe te ngarkúarit, edhe une do tju preh. Ngréreni zgjedhen time mi veten tuaj, dhe mesoni prej meje qe jam i bute dhe i perunjur nga zemra, dhe do te gjeni prehje ne shpirtin. Se zgjedha ime esht e lehte.

Psalmi 51 pa ze.

LAVDI. Me nermjetimet e Oshenarit, o meshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

TANI. Me nermjetimet e Hyjlíndeses, o meshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

Meshirome, o Perendí meshireplót, edhe shúaji paudhesít' e mia.

O Shen Andón me nam, virtuta ke leruar, çudira ke punuar, me lutje pra dhurona, Parajsen e Shenjtóreve.

SHKURTORJA, T. T. IV, TI IPERMAKHO

Prej foshnjerise, u-blatove si kurbán me mall, dhe me virtutat, shkrepctive Shen Andón me nam, per até qe te bekój perpara se te lintnje. Dhe u-çfaqe, si i par' i Oshenáreve, dhe si kollo-nizatór i shkretetírave; te therrés pra sot: Lum ti o Ashketí i Math.

SHTËPIA

Desherove urtesine qe prej foshnjerise, o Andón, At' i Shenjte Oshenár, dhe u-ndave prej bo-

tes dhe u-ngjite në qell, ku fitove kuroren e pafishkur të Oshenárëve, dhe u-lavdërove prej Krishtit në Parajsen e Shenjtórove. Perandáj, pra, të thërresim sot: Lum' ti o Ashketí i Math.

SINAKSARI

Me shtatembdhjetë të ketí múaji, kujtojmë Andonin e Math, Atin tonë Oshenár.

Gjithë sot, Akilláj, Ati ynë Oshenár, e mbaró jetën me paqe.

Me nermjetimet e tyre, o Perendí, meshirona. Amín.

ZBRITCSORET, T. III, KHERSON AVISOTOKON

(Ketó Zbratesore kendohen që më 15 të Jenarit gjër më 9 të Shkurtit.)

I. Fundin edhe burimin e avúshave, díelli një hér' e pá, se si mur u-bënë valat, edhe shkoj Israeli, më kembë neper më të detit, pertéj më këng' e brohorí: Le ta këdojmë Zotin, të lavdëruar më lavdí.

III. Zoti Krisht që i mpron besniket shpresëplote, forcojë dhe mproje Kishën e bekuar, që e mbolle më vojtje dhe më gjakun tent.

IV. Mbulove më virtuta qíellin o Zoti Krisht, kur linte prej Nënës Virgjërës, dhe u-shpure në Kishë si foshnjë në peqí, dhe i mbushe të gjitha më lavdí dhe brohorí.

V. Të pá Shen Isaia simbolërisht, mi fron të

lartë si Perendí, në Parajsen të rethuar prej En-gjejve, dhe thoshte i mjeri më tmerr: Ja e pashe Perendinë si njerí, Zotin Shpetimtarin, që na ndrit dhe në paqesón.

VI. Kur Simeoni të mori në krahët, dhe pá shpetimin për pópullin, i gezuar thirri: Ti je Zot' i Math e ti je Krishti.

VII. Hodhe vesën përmi zjarr, për Tre Djemtë Shpetimtár, edhe linte virgjërisht prej Hyjlíndesës, Perendí edhe Fjalë, besërisht të këdojmë, se i bekuar je ti o Perendí edhe Zot.

VIII. Në flag' e në zjarr të bashkuar, të Tre Djemat e bekuar të pangarë, më në më të furrës të vesuar, të këndonin më lavdí: E bekoni Zotin të gjithë më këngë, dhe e lartësoni përherë dhe për jetë.

O Hyjlíndese Marí, shpres' e të Krishtëreve, mprona rúajna se ti, streha jon' e vetem je.

IX. Në Ligjen dhe Shkronjen fáqeza, shohim shëmbell të Zotit Krisht: Çdo djal' i parëlindur kish prej Zotit, hir edhe bekím. Dhe në pra Fjalën që lindi, si Bir i parë në qell, dhe djal' i parë përmi dhé, më këdím e madhësojmë sot.

DERGIMCSORET, T. III, FOS ANALIOTON

O shkretëtirë gezohu, dhe lulczó si zambaku, se t' i ka shtuar pallatet, dhe bijt' e tu Shen Andoni, dhe ti o vend i Egjptës, këcé dhe ngazellohu, në ditën e sotme.

Ti o keshtjéll' e florinjte, më dymbëdhjetë for-

tesa, o fron që ndrit posi dielli, ku Mbreti rri me Shenjtoret, ti o çudi që s' ke kufi, o Nene Virgjeshë, që Zotin na linde.

LAVDERIMET, T. T. IV,
O TU PARADHOKSU

Atë Shen Andón o Ashketi, zgjedhen e Zotit Jesú, permi supet e ngre me gas, dhe perdhé e shtrin me Kryq, kryelartin Satán të zi, dhe me banorë, çdo shkretëtir' e mbush, me manastire, murge dhe Ashketinj. Lum ti o Oshenár, o lavdi e múrgeve pra Zotit Krisht, lutu-i për gjithë né, që të shpëtohemi.

Atë Shen Andón o Ashketi, për të fituar në qell, lumerit' e perjëthshime, në varrin i gjallë hyn, frikë s' ke prej demoneve, dhe kercenimet, s' ua përfill aspák, dhe faqebardhë, del me të fálurat. O trim i shpërthës, kryetar i múrgeve pra Zotit Krisht, lutu-i për gjithë né, që të shpëtohemi.

Atë i Shen Aterve Andón, si Ashketi të Jesújt, të nderojm' e të fállemi, shkove shkretëtirave, si në dasmë me ngazellim, edhe u-bere, prijës i múrgeve, pra të thërresim, me brohorí dhe nder: Lum' ti o Shen Andón, o lavdi e múrgeve pra Zotit Krisht, lutu-i për gjithë né, që të shpëtohemi.

LAVDI, T. II. O Shen Andón me nam, në botën u-degjove, demonet i dermove, dhe Engjëjt' i arrive, dhe shpirtet tona i shpëtón.

TANI. Zonjë Hyjlíndese, me lutje pranë Birit, çlirona nga mekatat, shpëtona dhe dhurona, Parajsen e Shenjtóreve.

SHKURTORJA, T. IV, O MITRAN.

O Zot që e shenjtërove Marinë Hyjlíndese, dhe plakun Shen Simeón, e bekoje në témpullin, arrí edhe taní, o meshireplót o Krisht Perëndí, edhe shtetin na e shpëtó prej gjithë lúfteve, dhe forcoji qeveritaret e pópullit, si mprojtes i njërsve.

APOSTULLI

Vdekja e Oshenarit është e nderuar përpara Zotit. Si do tja çpagaújme Zotit të gjitha të mirat?

Prej Letres së Palit për Hebrenjtë.

Vellezer, bindjuni krérove tuaj, dhe dëgjójini; se atá vigjellojne për shpirtet túaja, meqënëqë do të japin fjale për këtë gjë; se atëhere do të bëjnë me gezim dhe jo dyke psherëtitur; edhe kjo nuk është e dobishme për ju. Fáluni për né, se jemi të bindur që kemi ndergjëgjie të kthjellët, se jemi përpjekur të síllemi mirë me të gjithë; dhe më tepër ju lutem ta bëni këtë gjë, që të vendosem më shpejt pranë jush. Edhe Perendia i paqes, i cili e ngriti së vdëkuresh barinë e math të dhënve, Zotin tonë Jesú, me gjakun e dhjates së perjetme, ju stervitë për çdo veper të mirë, që ta mbaroni dëshirën e tij, dhe ju bëfte si ta

gjenje te pelqyer me anen e Jesú Krishtit, i cili paste lavdí ne jetet e jéteve. Amín.

UNJILLI PAS LUKAJT

M' até kohe, Jesúj qendrój ne nje fushe me grupin e Dishépujve dhe me nje shumice te madhe prej pópulli nga e tere Judea dhe nga Jerusalemi dhe nga anedeti i Tyres edhe Sidones, te cilet kishin ardhur qe ta degjonin dhe te sheróheshin prej semúndjeve dhe demóneve, edhe béheshin te shendoshe. Dhe pópulli i tere deshnin ta preknin; se nje force dilte prej atí, edhe i sherronte te gjithc. Dhe Jesúj i ngriti syte mi Dishépujte, dhe u tha: "Lum' ju te várferit, se Mbretëria e Perendise eshte júaja; lum' ju qe jini taní te uret, se do te ngínjeni; lum' ju qe qani taní, se do te qeshni; lum' ju, kur njérezit do tju urrejne, dhe do tju çkisherojne, dhe do tju perqeshin, dhe do tjua nxijne emrin per te Birin e njeriut. Gezóhuni até dite, dhe ngazellóhuni, se roga juaj do te jete e madhe ne qell."

KUNGATORJA

I drejti do te kujtohet per jete.

18. *Shen Thanasi dhe Shen Kirili.*

PERLESHORJA, T. III, THIAS PISTEOS

Ndritte veperisht Orthodoxsine, shtypte repesisht kakodoksine, edhe mundes tropeprures na dúallte; i pasuruat te gjitha me bes' e mall, dhe e stoliste Kishen me madheshti, keshtú e

gjette Zotin Krisht Perendí, qe fal per te gjithc meshire dhe shpetím.

THIRRTORET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Ndjekje edhe mergím, durove per te drejten, se shove heresite, dermove Ariosin, Thanás o Kryepríft i Math.

Besen e Zotit Krisht, kudó e proklamove, dhe mprove grigjen tende, dhe kishen Orthodoxse, Thanás o Kryepríft i Math.

Hirin e Shpirtit Shenjt, e çfaqe e leçite, dhe grigjen e shpetove, si nje barí i mire, Thanás o Kryepríft i Math.

Dogmat e Zotit Krisht, me zell i proklamove, leftove heretiket, i theve kundreshtaret, Kiríl o Kryepríft i Math.

Fjale me bukurí, leçite predikove, dhe zbukurove Kishen, dhe shigurove besen, Kiríl o Kryepríft i Math.

Si nje barí me fe, e mprove grigjen tende, dhe újqerit i dbove, dhe kishen e shpetove, Kiríl o Kryepríft i Math.

LAVDI. Yj te medhénj me nam, te Kishes Orthodoxse, qe thyet heresite, dhe shiguroat fenc, o Shen Thanás dhe Shen Kiríl.

TANI. Ti je m' e lúmura, nga grat' e tere botës, se linde Shpetimtarin, perkrahna dhe dhurona, Parajsen e Shenjtóreve.

PASVARGJET, T. T. I, KHERIS ASKITIKON

Lum ju o Kryepriester me nam, ju o fortesa madheshtore te Kishesve, kollona edhe keshtjella, dhe themeli dhe shkembinj, qe u dhate daten heretikeve; leçites te dogmave, dhe barinj te besnikeve, qe i ushqyet, me virtutat e Zotit Krisht, dbuat ujqerit, dhe i çdukte perçaresit; çpallesit e kanuneve, te Kishes se Zotit Krisht, o udheheqes te larte, qe ne Parajsen na shpini drejt. Pra Krishtit iu-lutni, te na fale per jete, meshire dhe shpetim.

Lum ju o Kryepriester me nam, Engjej qellore, qe baritte ketu mi dhe, shpetimin i dhate botes, dhe njerezise gezim, dhe u çpallte besen gjithë Kishesve; leçites te fjaleve, edhe mjekte te shpirtive, dhe çdo lengate trupesore te njeresve, te medhenj lumenj dhe liqene te Shpirtit Shenjt; ju qe po rithni fushave, dhe zbrisni luadheve, edhe vaditni kriesen me predikim te doktrineve. Pra Krishtit iu-lutni, te na fale perhere, meshire dhe shpetim.

Lum ju o Kryepriester me nam, yj te shkelqyer, te krieses se njeresve, pishtare qe shkrepetini, nje Perendi nje Trini, qe u jipni driten te verbuarve; o lule te bukura, te Parajses se Engjicjve, myra qellore, Shen Thanás Kryepriest i Math, Shen Kiril Patrik, o dishepuj te Shpirtit Shenjt; pllaka te gjithë dogmave, dhe kronj te shcrimeve, qe derthni vala shpetimi, dhe urtesie te hy-

jeshme. Pra Krishtit iu-lutni, te na fale perhere, meshire dhe shpetim.

LAVDI DHE TANI, T. T. IV. Le t' i lavderojme yjte e shkelqyer te Kishes, Patriket e medhenj, Mesonjesit e degjuar, Shen Thanás edhe Shen Kiril, dhe le tu therresim me nje ze: Nermjetoni perpara Krishtit, te na dhuronje ndjesen e mekátave, dhe perdellimin e math.

NDENJCSORET, T. T. I, TON SINANARKHON

O luath i doktrineve jetedhense, o udheheqes i Kishes dhe i besnikeve, qe durove gjithë vojtjet e mergimeve, o Kryepriest o Shen Thanás, te hymnojme bescrisht te gjithë sipas detyres, se lutesh prane Zotit, per shpetimin e besnikeve.

LAVDI DHE TANI. Lum' ti o porte qellore e Shpetimtarit Jesu, lum' ti mprojtj' e atyre qe po perikin me ty, o liman i dimeronjesve Hyjlindese, qe ke lindur mishcrisht, Krishtin njeri dhe Perendi, per ne nermjetó pa prere, se ty te lavderojme, dhe adhurojme Birin tent.

T. III, THIAS PISTEOS

Kryepriest i Math i Kishes sonc, Atc Shen Kiril na u-tregove, se me forcen e te dymbedhjetë fjaleve; e theve sektin e Nestorianeve, dhe e leçite Virgjreshen Hyjlindese; o mprojtes i dogmave, iu-lut Perendise Zotit Krisht, te na dhuronje ndjesen e mekátave.

LAVDI DHE TANI. Zonje Shen Marí banés'

e Fjales, Nen' e Zotit Krisht o Virgjereshe, qe kapercen nga bukuria gjithe Engjete; hith nje sy permi besniket dhe lutesit, se prej mekátave te zeza po mbytemi; atí pra lutu-i, o Zonje Marí Hyjlíndese, tu fale njeresve, meshire dhe shpetim.

T. I, TON TAFON SU

Besniket prifterinj, te Trinise se Shenjte, Patrikun Shen Thanás, bashke me Shen Kirilin, me kenge hymnojini, si leçites te dogmave, se me mish e shpirt, kane leftuar per besen, kunder újqerve, dhe heresive te zeza, ne mes te Sinodeve.

LAVDI DHE TANI. O Zonje Shen Marí, en' e zgjedhur e Zotit, na ngrer dhe na shpetó, né te mjeret qe humpme, ne pellk te deshperimeve, dhe ne pus te mekátave, se ti vetem je, shpetim per né mekatáret, ti je ndíhmese, edhe perkrahesh' e forte, dhe mprojtj' e besnikeve.

SHKALLESA KREMTORE, T. IV

Qe prej djalerise, shume pasione me leftojne, po ti perkrah-me dhe shpetome, o Shpetimtari im.

Ju qe urreni Sionen, do te turperoheni prej Zotit, dhe do te fishkeni si bari ne zjarr.

LAVDI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, merr jete çdo shpirt, dhe lartehet ne paqesi, dhe ndriçohet prej njesise Trinimore mistikerisht.

TANI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, rjedhin burimet e hirit, dhe vaditin tere kriesen per jetelindje.

PARCVARGU. Prifterinjt' e tu o Zot, do te vishen me drejtesi, dhe Oshenaret e tu do te ngazellohen.

UNGJILLI I MENGJEZIT PAS JOANIT

Zoti u tha Judenjve, qe i kishin ardhur: "Me te vertete, me te vertete po ju them: Aý, qe nuke hyn nga dera ne hoborin e dhenvë, po ngjitet gjétkazi, aý eshte vjedhes edhe kusár, edhe aý, qe hyn nga dera, aý eshte bariu i dhenvë. Atí ia hap deren portari, dhe aý i therrét me emer dhente, dhe i nxier jashte. Dhe kur i nxier jashte dhente, barét perpara atyre, dhe dhente i vene pas, se ia njohin zerin. Se nuk i vene pas nje te húaaji, po ikin prej tij, se nuk ua njohin zerin te húaajve." Keté parabolle ua tha Jesúj, po nuk i múarne vesh ató, qe u thoshte. Jesúj, pra, u tha perserí: "Me te vertete, me te vertete po ju them se une jam dera e dhenvë. Te gjithë atá, qe kane ardhur perpara meje jane vjedhes edhe kusars, edhe dhente nuk i degjuan. Une jam dera. Aý, qe hyn me anen time, do te shpetonje, dhe do te hynje, dhe do te dale, dhe do te gjenje kullotje."

Psalmi 51 pa ze.

LAVDI. Me nermjetimet e Kryeprifterve, o meshireplót, shúaaji paudhesít' e mia.

TANI. Me nermjetimet e Hyjlíndeses, o meshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

Meshirome, o Perendí meshireplót, edhe shúaji paudhesít' e mia.

T. T. II. Buzet ju derthne hir, o Ater Oshenare, edhe Barínj u-bete, te Kishes dhe leçitte, nje Perendí dhe nje Triní.

SHKURTORJA, T. IV, EPEFANIS.

Kryepriester te Medhénj, t' Orthodoxise, qe leftuat pa kursím, per fen' e Zotit Jesú Krisht, mprónani né qe therresim sot: Eja shpetona, o Zot i meshírave.

SHTËPIA

Me doren e forte dhe me fuqine qellore, o Zot i zemerdhempshur, e lartesove Kishen tende gjer ne qell, me yjt' e medhénj dhe te ndriçim, Shen Thanás edhe Shen Kiríl. Me nermjetimet e tyre, o Shpetimtár, o Zoti Krisht, largoje naten dhe mjégullen e armiqve, dhe ndritna né qe te therresim: Eja shpetona, o Zot i meshírave.

SINAKSARI

Me tetembedhjetë te ketí múaji, kujtojme, Thanasin dhe Kirilin, Aterit tane te Shenjte, Patriket e Aleksandrise.

Me nermjetimet e tyre, o Perendí, meshiro-na. Amín.

ZBRITCSORET, T. III, KHERSON AVISOTOKON

I. Fundin edhe burimin e avúshave, díelli nje hér' e pá, se si mur u-bene valat, edhe shkoj Israeli, me kembe neper mes te detit, pertéj me keng' e brohorí: Le ta kendojme Zotin, te lavde-ruar me lavdí.

III. Zoti Krisht qe i mpron besniket shpres-plote, forcoje dhe mproje Kishen e bekuar, qe e mbolle me vojte dhe me gjakun tent.

IV. Mbulove me virtuta qíellin o Zoti Krisht, kur linde prej Nenes Virgjereshë, dhe u-shpure ne Kishë si foshnje ne peqí, dhe i mbushe te gjitha me lavdí dhe brohorí.

V. Te pá Shen Isaia simbolcrisht, mi fron te larte si Perendí, ne Parajsen te rethuar prej Engjejve, dhe thoshte i mjeri me tmerr: Ja e pashe Perendine si njerí, Zotin Shpetimtarin, qe na ndrit dhe na paqesón.

VI. Kur Simeoni te mori ne krahet, dhe pá shpetimin per pópullin, i gezuar thirri: Ti je Zot' i Math e ti je Krishti.

VII. Hodhe vesen permi zjarr, per Tre Djemte Shpetimtár, edhe linde virgjerisht prej Hyjlíndeses, Perendí edhe Fjale, bescrisht te kendojme, se i bekuar je ti o Perendí edhe Zot.

VIII. Ne flag' e ne zjarr te bashkuar, te Tre Djemat e bekuar te pangare, mun ne mes te fures te vesuar, te kendonin me lavdí: E bekon

Zotin të gjithë me kënge, dhe e lartësoni përherë dhe për jetë.

O Hyjlíndese Marí, shpres' e të Krishtëreve, mprona rúajna se ti, streha jon' e vetem je.

IX. Në Ligjen dhe Shkronjen fáqeza, shohim shëmbell të Zotit Krisht: Çdo djal' i parëlindur kish prej Zotit, hir edhe bekím. Dhe né pra Fjalën që lindi, si Bir i parë në qell, dhe djal' i parë përmi dhé, me këndím e madheshtojme sot.

DËRGIMËSORET, T. II, TIS MATHITES

Dishepuj të Mesónjesit, të Perëndisë Zotit Krisht, Thanás o Kryepíft i Math, dhe Kiríl i trishlumur, mprojtes të Kishës së Shenjtë, që i thyet nderit, e Ariosit faqezí, dhe Nestorit të verber dhe besëlik, dhe i çdukte prallat edhe gënjeshtrat, e gjithë heretikeve, Patrikë të Trínisë.

O Shen Marí Hyjlíndese, mprona prej çdo reziku, mprona prej hidherímeve, mprona prej çdo nevoje, dhe mos na lër të na marrë, djalli ditën e funtme, as Ferr' i ertesírave, mprona përpara gjyqit të Birit tënt, nxirna faqebardhë o Virgjreshë, si Nen' e Zotit ti i ke, që të gjitha në dorë.

LAVDËRIMET, T. I, TON URANION

Besnikë eni të gjithë që ta kremtojmë sot, kujtimin e nderuar të Mesónjesve tanë, që mposhtn' e çkaterruan çdo heresí, me shigjetat e Shpirtit

Shenjt, dhe i shpëtuan traditat e Zotit Krisht, edhe Kishën e besnikëve.

Si yj të ndriçim të Kishës së Orthodókseve, Mesónjes të shkelqyer, na ndriçuat me fjale, se gojen heretike njeri prej jush, Ariosit ia mbylli krejt, dhe tjetri mundi Nestorin demoniak, dhe Sabelin mendjeprishurin.

Me nermjetimet e nxehta të Kryepífterve, nga qelli vizitona, Zoti Krisht me meshirë, dhe grigjen Orthodokse mproje me vrap, nga çdo ujë e çdo heretik, se na përçajn' e na çthurin me pabesí, me shigjetat e demoneve.

Të dy Mesónjesit tanë dhe Kryepífterit, të Shpëtimtarit tonë dhe të Kishës së Shenjtë, Thanasin dhe Kirilin Patriket me nam, le t' i lusim me brohorí, se nermjetojnë në qiellin gjithënjë, për shpëtimin e besnikëve.

LAVDI, T. T. I. Ejani besnikë Orthodokse, t' i kurorëzojmë me kënge, të dy Mesónjesit e nderuar; se me fuqinë e Perëndisë, e përndanë ertesírën e heretikeve, dhe e ndritën botën me dritën e dógmave, dhe nermjetojnë pa pushím për né, që ua kremtojmë kujtimin besërisht.

TANI. Ti je m' e lúmura, nga grat' e tërë botës, se lindi Shpëtimtarin. Përkrahna dhe dhurona, Parajsen e Shenjtóreve.

SHKURTORJA, T. I, O MITRAN.

O Zot që e shenjterove Marinë Hyjlíndese, dhe plakun Shen Simeón, e bekove në témpullin, arrí

edhe taní, o meshireplót o Krisht Perendí, edhe shtetin na e shpetó prej gjithë lúfteve, dhe forcoji qeveritaret e pópullit, si mprojtes i njëresve.

APOSTULLI

Vdekja e Oshenarit është e nderuar përpara Zotit. Si do tja çpagúajme Zotit të gjitha të mirat?

Prej Letres së Palit për Hebrenjtë.

Vellezer, bínjuni kréreve tuaj, dhe degjójini; se atá vigjellojnë për shpirtet túaja, meqéneqë do të japin fjale për këtë gjë; se atchere do të bëjnë me gezím dhe jo dyke psherëtitur; edhe kjo nuk është e dobishme për ju. Fáluni për né, se jemi të bindur që kemi ndërgjéjgie të kthjellët, se jemi përpjekur të silllemi mirë me të gjithë; dhe më tepër ju lutem ta bëni këtë gjë, që të vendosem më shpejt pranë jush. Edhe Perendia i paqes, i cili e ngriti së vdekurësh barinë e math të dhëne, Zotin tonë Jesú, me gjakun e dhjates së perjetme, ju stervitte për çdo veper të mirë, që ta mbaroni dëshirën e tij, dhe ju bëfte si ta gjenjë të pelqyer me anën e Jesú Krishtit, i cili pastë lavdí në jetet e jéteve. Amín.

UNGGJILLI PAS MATTHEUT

Zoti u tha Dishépujve: Ju jini drita e botes. Një qytét, i vendosur mi një mal, nukë munt të fshihet. Edhe kur e ndezin kandilin, nuk e vënë nënë shinikun, po përmi kandilerin, që tu ndrite

të gjithë atyre, që ndodhen në shtëpi. Kështu le të shkelqenjë drita juaj përpara njëresve që t' i shikojnë veprat túaja të mira, dhe ta lavderojnë Atin tuaj, që është në qell. Mos pandehni se kam ardhur ta prish ligjen edhe profetet. Nukë kam ardhur ta prish po ta plotesónj. Se me të vertetë po ju them, gjer sa të prishet qelli edhe dheu, dhe gjer sa të mbarohen të gjitha, asnjë jotë dhe asnjë vijë e ligjes nukë do të prishet. Aý, pra, që shkel më të vogëlën prej këtyre porrosive, a i mesón njërezinë t' i shkelin, do të quhet më i vogeli në Mbretërinë e qellit; po cilidó, që i zbatón, dhe i predikón, aý do të quhet i math në Mbretërinë e qellit.

KUNGATORJA

I drejti do të kujtohet për jetë.

19. *Makari Egjiptiani, Ati ynë Oshenár; Arseni i Korfuzit, Ati ynë i Shenjtë; Marku Eugjeniku, Ati ynë i Shenjtë, Mitropoliti i Efeses.*

PERLESHORJA E MARKUT TË EFESGJ, T. III, THIAS PISTEOS

Besën e Jesújt e proklamove, dhe zellót i math i Kishes sonë, u-tregove o i lumur i Shenjtë Mark, dhe dolle mprojtes i dógmave t' Aterve, dhe hodhe poshtë mburrjet e érreta. Perandáj pra ti, përpara Zotit Krisht po nermjetó, të na dhuronjë ndjesen e mëkátave.

20. *Shen Efthimi i Math, Ati ynë Oshenár dhe hyjprures.*

PGRLESHORJA E SHEN EFTHIMIT, T. IV.

Gezohu shkretetír' e papjéllshime, defré o toke e papémshime; se femijet t' i ka shtuar, njeriu me deshirat e Shpirtit Shenjt; se i mbolli me besë, dhe i rriti me perkore, dhe me virtuta të mbarúara. Me lutjet e tyre o Krisht Perendí, shpetoji shpirtet tona.

THIRRTORET, T. T. I, KHERIS ASKITIKON

Lum ti o Ashketí Shen Thimí, thesár dhe arke, e shkelqyer e vójtjeve, se Kryqin mi sup e ngrite, dhe Zotit Krisht pas i ré, dhe sakrifikove veten pa kursím; deshirat e póshtera, trupesore perdhé i shkel, dhe me virtuta, shpirtin tent e stolís e ngre, dhe me zell qellór, si Parajsen e larteson. Pra sot ketú po mblídhemi, kremtojme kujtimin tent, o Shen Thimí i degjuar, dhe të perlotur të lútemi; na mpro pranë Zotit, dhe të gjithëve dhurona, meshire dhe shpetím.

Ndrit si thengjill i ndezur në qell, i frymesuar si Profetet prej Shpirtit Shenjt, në botën fitove fame, dhe predikove kudó, fjalet e Ungjillit, plot me ngazellím; dhe dritën që s' perëndón, e përhapë kudó mi dhé, dhe shkretetirën, e vesovë që lartazi, dhe thengjijt' e saj i flladite çuditërisht. Pra kryetari Zoti Krisht, kuroren e múndjeve, të ka dhuruar o Atë edhe Parajsen e Engjejeve; përpara tij mprona, dhe të gjithëve dhurona, meshire dhe shpetím.

Shkallë që lart në qellin arrin, o At i Shenjtë,

na u-çfaqë mi dhënë ti, u-ngrite përpara Zotit, dhe me Jesunë po flet, Oshenár i lumur, ashketí me nam; dhe dritën e qíellit, dhe t' Ungjillit të Zotit Krisht, e predikove, nga tribunat e Kísheve, edhe njërezit, i ndriçovë me bes' e mall; pranë Parajsen je taní, dhe lutesh për gjithë né, që ta kremtojme kujtimin, përunjësisht dhe të lútemi; na mpro pranë Zotit, dhe të gjithëve dhurona, meshire dhe shpetím.

LAVDI, T. II. O Shen Thimí me nam, virtuta ke lëruar, çudira ke punuar, me lutje për dhurona, Parajsen e Shenjtóreve.

TANI. Çdo shprehtë me ty e varr, Marí o Hyjlíndese, Nen' e Zotit Krisht, ti me ruaj përher' e ti me mpro.

PASVARGJET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Çfaqesh në vogelí, i zgjédhuri i Zotit, dhe en' e shenjteruar, o At i frymesuar, prej Krishtit dhe prej Shpirtit Shenjt.

Kryqin në dor' e mban, o Ashketí i lumur, dhe djajtë dhe demonet, fantazmat dhe kuçedrat, o At' i çkaterrovë krejt.

Djajtë i shtype krejt, dhe faqebardhë dolle, me Kryqin dhe me Krishtin, edhe u-lavdërovë, o Atë Oshenár me nam.

LAVDI DHE TANI, T. II. Pate keq dashurí, për bukurít' e qellit, dhe gjárperin e shkele, dhe shkove në Parajsen, dhe lutesh gjithënjë për né.

NDËNJËSORET, T. I, TON TAFON SU

Jetove shpresërisht, permi dhene o Ate, i pastër dhe pa cen, si i zgjedhur i Zotit, si drite udhëhëqese, e të gjithë besnikëve, pra të lútemi, të nermjetósh pranë Krishtit, të shpetóhemi, o Shen Thimí i dëgjuar, o Ate lavdí me ty.

LAVDI DHE TANI. Si nene të Jesújt, që të gjithë të njohim, o Zonjë Shen Marí, Virgjereshe pas lindjes, perikim pra me ty me mall, si e mirë që je për né; ty të kemi pra, né mekatarët si mprojtje, prej rezíkeve, dhe shpetimtare në ngasjet, o Nene Hyjlíndese.

T. T. IV, PAS TIN SOFIAN

More Kryqin e Zotit tonë Jesú, edhe pas e vazhdove gjer në mbarím, dhe prapë s' u ktheve mé, në qytetet e njëresve, me përmbajtje dhe vajtje, pesimet i vrave krejt, dhe e bërë trupin një tempull të Shpirtit Shenjt; more pra dhuratat, për mundimet e renda, lengatat të na shërósh, dhe demonet të na i dbosh, o Thimí Oshenár me nam, lutju Krishtit Perendí, të na dhuronjë ndjesën e mekátave, neve që sot e kremtojmë, besërisht kujtimin tënt.

LAVDI DHE TANI. Shpirtin tim të perunjur o Shen Marí, që në shqoten e jetës brenda në det, po rrihet prej ëreve, dhe perpiqet prej vólave, edhe nga barr' e mekatit, po mbytet prej újve, edhe në funt të Ferrit po kridhet taní me vrap; eja Virgjereshe, dhe me lutjet e nxehta, shpë-

tomë dhe shpërme shpejt, në limán dhe në qetesí, se me besë po të therrës: Lut-u-i Birit Jesú Krisht, të na dhuronjë ndjesën e mekátave, se me ty kemi shpresë, gjithë të pavërit.

T. T. IV, TIN SOFIAN

Çdo të mirë të jetës, prapa e lé, edhe ndónese kishe trupin mi dhé, u-bërë si Engjëjts, edhe rronjë në qíellin; se për çudí i shovë, pesimet e trupit tënt, edhe shok i Trinisë, u-çfaqë me lumëri; pra shërón semundjet, dhe lengatat e trupit, dhe dbon çdo demón të lik, me një fjal' e një porrosí, o Shen Thimí Oshenár me nam, lutju Krishtit Perendí, të na dhuronjë ndjesën e mekátave, neve që sot e kremtojmë, besërisht kujtimin tënt.

LAVDI DHE TANI. Ti o portë qellore o Shen Marí, ti o mali i shenjts plot me shkëlqím, o rë urhëhëqese, ti o shkalla e qëllshime, ti o Parajs' e méndëshme, për Even shpetónjëse, ti o thesár i botes i shtrenjtë i çmúarshim; ti o Nen' e Shenjtë, ti shpetimin na solle, nga fajet e prín-derve, dhe mallkimet e gjýsherve. Përandáj të therrësim: Nermjetó pranë Birit tënt, të na dhuronjë ndjesën e mekátave, neve që sot e kremtojmë, besërisht kujtimin tënt.

SHKALLESA KREMTORE, T. IV

Që prej djalerisë, shumë pasione me leftojne,

po ti perkrah-me dhe shpetome, o Shpetimtari im.

Ju qe urreni Sionen, do te turperoheni prej Zotit, dhe do te fishkeni si bari ne zjarr.

LAVDI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, merr jete cdo shpirt, dhe lartsohet ne paqesi, dhe ndriçohet prej njesise Trinisore mistikerisht.

TANI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, rjedhin burimet e hirit, dhe vaditin tere kriesen per jetelindje.

PARCVARGU. Vdekja e Oshenarit esht e nderuar perpara Zotit.

UNGJILLI I MËNGJJEZIT PAS MATTHEUT

Zoti u tha Dishépujve: Te gjitha m' i ka dorëzuar im-Atë; dhe asnjë nuk e njeh Birin pervéc Atit; edhe asnjë nuk e njeh Atin pervéc Birit edhe atí, te cilit Biri do tja zbulonje. Ejani tek une te gjithë te lódhurit edhe te ngarkúarit, edhe une do tju preh. Ngréreni zgjedhen time mi veten tuaj, dhe mesoni prej meje qe jam i bute dhe i perunjur nga zemra, dhe do te gjeni prehje ne shpirtin. Se zgjedha ime esht e mire, dhe barra ime esht e lehte.

Psalmi 51 pa ze.

LAVDI. Me nermjetimet e Oshenarit, o meshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

TANI. Me nermjetimet e Hyjlíndeses, o meshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

Meshirome, o Perendí meshireplót, edhe shúaji paudhesít' e mia.

O Shen Thimí me nam, virtuta ke leruar, çudira ke punuar, me lutje pra dhurona, Parajsen e Shenjtóreve.

SHKURTORJA, T. T. IV, TI IPERMAKHO

Prej foshnjerise, u-blatove si kurbán me mall, dhe me virtutat, shkrepctive Shen Thimí me nam, per até qe te bekój perpara se te lintnje. Dhe u-çfaqe, si i par' i Oshenárave, dhe si kollonizatór i shkretetírave; te therrés pra sot: Lum ti o Ashketí i Math.

SHTËPIA

Desherove urtesine qe prej foshnjerise, o Thimí, At' i Shenjte Oshenár, dhe u-ndave prej botës dhe u-ngjite ne qell, ku fitove kuroren e pafishkur te Oshenárave, dhe u-lavdrove prej Krishtit ne Parajsen e Shenjtóreve. Perandáj, pra, te therresim sot: Lum' ti o Ashketí i Math.

SINAKSARI

Me njezét te ketí múaji, kujtojme Efthimin e Math, Atin tone Oshenár.

Gjithe sot, kujtojme Basin, Efsebin, Eftikun, dhe Basilidin, Deshmoret e Shenjte.

Gjithe sot, kujtojme Innane, Pinnane dhe Rimmane, Deshmoret e Shenjte.

Gjithë sot, kujtojmë Pjetrin, Publikanin e lumur.

Me nermjetimet e tyre, o Perendí, mehiro-na. Amín.

ZBRITCSORET, T. III, KHERSON AVISOTOKON

I. Fundin edhe burimin e avúshave, díelli nje hér' e pá, se si mur u-bene valat, edhe shkoj Is-raeli, me kembe neper mes te detit, pertéj me keng' e brohorí: Le ta kendojmë Zotin, te lavde-ruar me lavdí.

III. Zoti Krisht qe i mpron besniket shpres-plote, forcoje dhe mproje Kishen e bekuar, qe e mbolle me vojte dhe me gjakun tent.

IV. Mbulove me virtuta qíellin o Zoti Krisht, kur linde prej Nenes Virgjereshë, dhe u-shpure ne Kishë si foshnje ne peqí, dhe i mbushe te gji-tha me lavdí dhe brohorí.

V. Te pá Shen Isaia simblerísht, mi fron te larte si Perendí, ne Parajsen te rethuar prej En-gjejve, dhe thoshte i mjeri me tmerr: Ja e pashe Perendine si njerí, Zotin Shpetimtarin, qe na ndrit dhe na paqesón.

VI. Kur Simeoni te mori ne krahet, dhe pá shpetimin per pópullin, i gezuar thirri: Ti je Zot' i Math e ti je Krishti.

VII. Hodhe vesen permi zjarr, per Tre Djem-te Shpetimtár, edhe linde virgjerísht prej Hyj-

lir. deses, Perendí edhe Fjale, bescrísht te ken-dojmë, se i bekuar je ti o Perendí edhe Zot.

VIII. Ne flag' e ne zjarr te bashkuar, te Tre Djemat e bekuar te pangare, mun ne mes te fu-rrës te vesuar, te kendonin me lavdí: E bekoni Zotin te gjithë me kenge, dhe e lartësoni perhe-re dhe per jete.

O Hyjlíndese Marí, shpres' e te Krishtëreve, mprona rúajna se ti, streha jon' e vetem je.

IX. Ne Ligjen dhe Shkronjen fáqeza, shohim shembell te Zotit Krisht: Çdo djal' i parelindur kish prej Zotit, hir edhe bekím. Dhe né pra Fja-len qe lindi, si Bir i pare ne qell, dhe djal' i pare permi dhé, me kendím e madheshtojme sot.

DERGIMCSORET, T. III, FOS ANALIOTON

O shkretetire gezohu, dhe lulczó si zambaku, se t' i ka shtuar pallatet, dhe bijt' e tu Shen Thi-miu, dhe ti o vend i Judese, kecé dhe ngazellohu, ne ditën e sotme.

Ti o keshtjéll' e florinjte, me dymbedhjetë for-tesa, o fron qe ndrit posi díelli, ku Mbreti rri me Shenjtoret, ti o çudí qe s' ke kufí, o Nene Virgje-reshe, qe Zotin na linde.

LAVDERIMET, T. I, TON URANION

Ti qe perbuze te mirat e ketí shékulli, dhe pate mall per qellin edhe per shkretetiren, o Ate Shen Thimí te gjithë na fton, ta kremtojmë kujtimin

tent, së pranë Zotit përherë po nermjetón, për shpëtimin e besnikëve.

Në botë s' deshe gjë tjetër përveç virtutëve, me të e lavdërova përmi dhe në sa rrojte, Jesunë Shpëtimtarin me ngazellim, dhe fitova lavdi në qell, edhe shërime lengatash po na burón, o Shenë Thimí Oshenár me nam.

I mir' i matur i butë edhe i embël fort, ke qen' o At i Shenjtë, përmi çdo njeri tjetër, dhe tempull shpirtëror i Zotit Jesú, u-tregova ketú mi dhé, edhe dhurata shëronjëse po u fal, pasurisht adhurónjëseve.

LAVDI, T. II. O Shenë Thimí me nam, në botën u-degjova, demonët i dërmova, dhe Engjëjt' i arrive, dhe shpirtet tona i shpëtón.

TANI. Zonjë Hyjlíndese, me lutje pranë Birit, çlirona nga mekatat, shpëtona dhe dhurona, Parajsen e Shenjtëve.

SHKURTORJA, T. IV, O MITRAN.

O Zot që e shenjterove Marinë Hyjlíndese, dhe plakun Shenë Simeón, e bekova në tempullin, arrí edhe taní, o meshirëplót o Krisht Perëndí, edhe shtetin na e shpëtó prej gjithë luftëve, dhe forcoji qeveritaret e pópullit, si mprojtes i njëresve.

APOSTULLI

Vdekja e Oshenarit është e nderuar përpara Zotit. Si do tja çpaguejme Zotit të gjitha të mirat?

Prej Letres së Palit për Hebrenjtë.

Vellezer, bindjuni krëreve tuaj, dhe degjëjini; se atá vigjëlojnë për shpirtet túaja, meqënëse do të japin fjale për këtë gjë; se atëherë do të bëjnë me gezim dhe jo dyke psherëtitur; edhe kjo nuk është e dobishme për ju. Fáluni për në, se jemi të bindur që kemi ndergjëgjie të kthjellët, së jemi përpjekur të sillëmi mirë me të gjithë; dhe më tepër ju lutem ta bëni këtë gjë, që të vendosem më shpejt pranë jush. Edhe Perëndia i paqes, i cili e ngriti së vdëkuresh barinë e math të dhënve, Zotin tonë Jesú, me gjakun e dhjates së përjetme, ju stervitë për çdo veper të mirë, që ta mbaroni dëshirën e tij, dhe ju bëftë si ta gjenjë të pelqyer me anën e Jesú Krishtit, i cili pastë lavdi në jetet e jëteve. Amín.

UNJILLI PAS LUKAJT

M' atë kohë, Jesúj qëndrój në një fushe me grupin e Dishëpujve dhe me një shumicë të madhe prej pópulli nga e terrë Judea dhe nga Jerusalemi dhe nga anedeti i Tyres edhe Sidones, të cilët kishin ardhur që ta degjënin dhe të shëroheshin prej sëmundjeve dhe demoneve, edhe bëheshin të shëndoshe. Dhe pópulli i terrë dëshnin ta preknin; se një forcë dilte prej atí, edhe i shëronte të gjithë. Dhe Jesúj i ngriti sytë mi Dishëpujtë, dhe u tha: "Lum' ju të vërferit, së Mbretëria e Perëndisë është júaja; lum' ju që jini taní të urtë, se do të ngínjeni; lum' ju që qani taní, se do të qeshni; lum' ju, kur njërezit do tju urrejne,

dhe do tju çkisherojnë, dhe do tju perqeshin, dhe do tju nxijne emrin per te Birin e njeriut. Gezohuni até dite, dhe ngazellohuni, se roga juaj do te jete e madhe ne qell.”

KUNGATORJA

I drejti do te kujtohet per jete.

21. *Maksimi, Ati yne Oshenár; Neofiti, Deshmori i Shenjte.*

22. *Timotheu, Apostulli i Shenjte; Anastasi Persani, Deshmori i Shenjte dhe Oshenár.*

PERLGSHORJA E SHEN TIMOTHEUT, T. I.

Mesove butesine, zbatove perkoren, dhe u-veshe me ndergjégjien e mire prifterisht, mesove prej Shpetimtarit te fshehtat, dhe e ruajte besen, e mbarove rendjen e drejte, Hierodeshmór i Shenjte Timothé. Lutju Zotit Perendí, te shpetohen shpirtet tona.

PERLGSHORJA E ANASTASIT PERSANIT, T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Deshmori yt o Zot, me vojte lot e mundím, kurore te ndrícime prej teje mori sot, si roge dhe si çperblím; se me fuqine tende, ka rrezuar tiranet, dhe ka dermuar djajte, e kuxímt' e te dobet; ay per né po te lutet o Krisht Perendí, te shpetohen shpirtet tona.

23. *Klementi i Ankires, Hierodeshmori i Shenjte; Agathangjeli, Deshmori i Shenjte.*

PERLGSHORJA E AGATHANGJELIT, T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Deshmori yt o Zot, me vojte lot e mundím, kurore te ndrícime prej teje mori sot, si roge dhe si çperblím; se me fuqine tende, ka rrezuar tiranet, dhe ka dermuar djajte, e kuxímt' e te dobet; ay per né po te lutet o Krisht Perendí, te shpetohen shpirtet tona.

24. *Ksenia, Nena jone Oshenare.*

25. *Shen Grigori.*

PERLGSHORJA E SHEN GRIGORIT, T. I.

Me fyellin e theollogjise o kryebarí, munde trumbetat e gjithe oratóreve; se shtudiove thelesít' e mejtimeve, edhe gjete bukurít' e fjalímeve; nermjetó prane Krishtit Perendí, o Shen Grigór per né, te shpetohen shpirtet tona.

THIRRTORET, T. T. I, KHERIS ASKITIKON

Lum' ti o Kryeprift shembellór, ti o kollone, e patundur e Kísheve, lavdí e Orthodoksise, qe ke buruar çudí, lum' i dashurise, qe po rjeth per né; o yll qe shkelqén dhe ndrit, instrumenti i Shpirtit Shenjt, mendje qellore, zemerbuti me hir dhe nder, i stolísuri me virtút dhe perunjesi; o meshtar dhe Shenjt me nam, o Engjell i qiellit, o punetór i vreshtes, o mik i fjeshte i Zotit Krisht; pra lutju pa prere, qe besnikëve tu fale, meshire dhe shpetím.

Dhene dhe qellin e trashegón, si zemerbutë, qe

u-çfaqe në njërezit, o Atë i lavdëruar, që me fuqi dhe me ment, dhe me fjale t' urta, dhe me hir qëllor; armiqte e Zotit Krisht, heretiket e liq pa ment, i shtype fare, edhe besën e hýjeshme, dhe shpëtónjese, lart e ngrite me Shpirtin Shenjt; ti u tregove Kísheve, me drit' e me predikim, ta lavdërojmë Jesunë të bashkëqenshim në një Tríní; me Atin pa nisje, që i fali tërë botes, meshire dhe shpëtím.

Brenda në tempull brenda n' alltár, i shenjteruar, ke shkelqyer si Kryeprift, me vepra dhe teorira, me urtesí dhe me ment, veshur me stolira të shkelqýera; taní pra në qëll, përpara Zotit o Oshenár, n' alltár të lartë, po meshón tok me Gngjeytë, si ketú mi dhé, nëpër Kishet e njëresve; mos na harró po na kujtó, Grigór Kryeprift i Math, né që po lusim me besë, kujtimin tënt edhe nermjetó; për né kurdoherë, që Jesúj të na dhuronjë, meshire dhe shpëtím.

LAVDI DHE TANI, T. II. Një Perëndí dhe Zot, në një Tríní të Shenjtë, me Atin edhe Birin, dhe Shpirtin e bekuar, leçite Shen Grigór me nam.

PASVARGJET, T. T. I, KHERIS ASKITIKON

Lum' ti o instrumént muzikál, i frymesuar prej Jesúj dhe prej Gngjeytë, që fole dhe predikove, dhe këshillove me zell, edhe na mësove të pendóhemi; i urtë i artë Shenjt, dallendryshe këndónjese, pullúmp i bukur, ligjeronjes i psál-

meve, si florí shkelqén, në luáth të virtútave; krua midis lëndínave, që rjeth midis lúleve, o goj' e shenjte që solle, vëllazerí midis njëresve. Iu-lut Jesúj Krishtit, të na falë kurdoherë, meshire dhe shpëtím.

Lum' ti që mpron jetimet si At, ti o perkraheje e të gjithë të shtýpurve, o mprojtje e varferisë, dhe i urisë ushqím, ndreqje e shigúrt' e mekatáreve; o mjeku i shpírteve, dhe i gjithë lengátave, ti o Mësonjes, theollóg i doktrínave, ti që na shpjegón, Testamentet e Shpirtit Shenjt; ligjë që çapet në caktón, kanún që na shpie drejt, o teorí dhe praktike, o urtesí pa kufí dhe funt. Iu-lut Jesúj Krishtit, të na falë kurdoherë, meshire dhe shpëtím.

Ti o pallát i lartë me ar, plot me virtuta, dhe zilí shenjterónjese, se ty të bënë banesë, si nonjë tempull qëllor, ty o At i Shenjtë Kryeprift i Math; se urtë dhe plot me ment, veperimet e ndjénjave, i qeverisë, edhe shpirtin e rúajte, si thesár të math lark psímeve çthúrcë; pra si i par' i Gngjeytë, u-çfaqë o Shenjt i Math, o Kryeprift i bekuar, edhe kollona e kísheve. Iu-lut Jesúj Krishtit, të na falë kurdoherë, meshire dhe shpëtím.

LAVDI DHE TANI, T. II. Zonjë Hyjlíndëse, që lindi Jesúj Krishtin, për né pa prerë lutu, me Shen Grigór Patrikun, o Nënë shpirtet na shpëtó.

NDËNJËSORET, T. T. I, TON SINANARKHON

O luadhi i Fjales dhe i Shkriptúrave, që na ben të besojmë dhe të pendohemi, që durove gjithë ngasjet e demoncëve, né besniket o Grigór, dhe dishépujtë me mall, siç duhet po të nderojmë, se lutesh përpara Zotit, për shpëtím të gjithë shpirtëve.

LAVDI DHE TANI. Virgjereshe dhe Nene Marí Hyjlíndese, që hidherimin e Evës e ktheve në gezím, të hymnojmë né besniket dhe të fálemi, se na çlirove plotërisht, nga mallkimi prinderór, o Zonj' e permibekuar, pra lutu për né pa prerc, dhe shpëtona prej rezíkeve.

T. I, TON TAFON SU

Grigór o Theollóg, që je pranë Trinisë, iu-lut për gjithë né, që të lusim me besë, në ditën e tmërrshime, dhe në gjyqin e fájeve, eja nermjetó, që të na ndjehen mekatat, se me goj' e shpirt, po të kendojmë përherë, o miku i njëresve.

LAVDI DHE TANI. O Krisht o Krijetár, Zot i botes së tere, që je me Atin tok, dhe me Shpirtin e Shenjtë, si foshnje u-rethpreve sot, përmi dhene pas tete ditsh. Vepr' e hýjeshme, dhe e çudíçime eshte, kjo që ben për né, se për shpëtimin e botes, përmbushe Kanunin sot.

T. T. IV, TIN SOFIAN

Me fuqinë mendore po i përmbýs, që të gjith'

heretiket pa përjashtëm, doktrinat e shtrémbera, t' Ariosit plot me t'erbím; edhe leçite në botën, Jesusë si Perendí, edhe armiqtë e çthure me zgjatjen e dúarve; tutje e largove, heresín' e Sabelit, dhe rremat e çmëndura, të Nestorit i çduke krejt; Shen Grigór o Patrik i Math, lutu-i Jesújt Perendí, të na falë ndjesën e mekátave, sot që kremtojmë të gjithë, beserisht kujtimin tënt.

LAVDI DHE TANI. Shpirtin tim të perunjur o Shen Marí, që në shqotën e jetës brenda në det, po rrihet prej éreve, dhe perpiqet prej vâlave, edhe nga barr' e mekatit, po mbytet prej újeve, edhe në funt të Ferrit po krijhet taní me vrap; eja Virgjereshe, dhe me lutjet e nxehta, shpëtojmë dhe shpërme shpejt, në limán dhe në qetesí; se me besë po të therrés: Lutu-i Zotit Jesú Krisht, të na dhuronjë ndjesën e mekátave; se me ty kemi shpresë, gjithë të pavýerit.

SHKALLESA KREMTORE, T. IV

Që prej djalerisë, shumë pasione më leftojnë, po ti perkrahem dhe shpëtojmë, o Shpëtimtari im.

Ju që urreni Sionën, do të turpëroheni prej Zotit, dhe do të físhkeni si bari në zjarr.

LAVDI. Me anën e Shpirtit të Shenjtë, merr jetë çdo shpirt, dhe lartësohet në paqesí, dhe ndriçohet prej njesisë Trinisore mistikerisht.

TANI. Me anën e Shpirtit të Shenjtë, rjedhin burimet e hirit, dhe vaditin tërë krijesën për jetelindje.

PARCVARGU. Goja ime do te flase urtesí, dhe zemra ime kupetím.

UNGGJILLI I MËNGJJEZIT PAS JOANIT

Zoti u tha Judenjve, qe i kishin ardhur: “Me te vertete, me te vertete po ju them: Aý, qe nuke hyn nga dera ne hoborin e dhenve, po ngjitet gjétkazi, aý eshte vjedhes edhe kusár, edhe aý, qe hyn nga dera, aý eshte bariu i dhenve. Atí ia hap deren portari, dhe aý i therrét me emer dhente, dhe i nxier jashte. Dhe kur i nxier jashte dhente, barét perpara atyre, dhe dhente i vene pas, se ia njohin zerin. Se nuk i vene pas nje te húaaji, po ikin prej tij, se nuk ua njohin zerin te húaajve.” Keté parabolle ua tha Jesúj, po nuk i múarne vesh ató, qe u thoshte. Jesúj, pra, u tha perserí: “Me te vertete, me te vertete po ju them se une jam dera e dhenve. Te gjithe atá, qe kane ardhur perpara meje jane vjedhes edhe kusare, edhe dhente nuk i degjuan. Une jam dera. Aý, qe hyn me anen time, do te shpetonje, dhe do te hynje, dhe do te dale, dhe do te gjenje kullotje.”

Psalmi 51 pa ze.

LAVDI. Me nermjetimet e Kryepriftit, o meshireplót, shúaaji paudhesít' e mia.

TANI. Me nermjetimet e Hyjlíndeses, o meshireplót, shúaaji paudhesít' e mia.

Meshirome, o Perendí meshireplót, edhe shúaaji paudhesít' e mia.

T. T. II. Buzet te derthne hir, Grigór o At i Shenjte, edhe Barí u-bere, i Kishes dhe leçite, nje Perendí dhe nje Triní.

SHKURTORJA, T. III, EPEFANIS

Themelí e Kísheve, e patronditur, u-tregove ne rezík, o Kryeprift i Zotit Krisht, o theollóg i doktrínave, Engjell i qellit, Grigór Oshenár i Math.

SHTËPIA

O en' e perkores, o goj' e urtesise, o themelí e dógmave, Shen Grigór i Math, qe shkrepetin ne mendjen e te gjitheve. Ejani ta kremtojme dhe te ndriçohemi prej shpirtit te tij. Ejani ta imitojme besen edhe zellin edhe perunjesine e tij, se u-tregua tempull i Perendise. Perandáj e lavderojme, dhe i therresim me brohorí: Engjell i qellit, Grigór Oshenár i Math.

SINAKSARI

Me njezét e pese te ketí múaji, kujtojme Grigorin Theollogun, Atin tone te Shenjte, kryepeshkopin e Kostandinopjes.

Gjithe sot, kujtojme Publin, Atin tone Oshenár. Gjithe sot, kujtojme Marin, Atin tone Oshenár.

Gjithe sot, Shen Medula e mbarój jeten e djegur ne zjarr.

Gjithe sot, kujtojme Dimitrin, Atin tone Oshenár.

Me nermjetimet e tyre, o Perëndí, meshirona. Amín.

ZBRITGSORET, T. III, KHERSON AVISOTOKON

I. Fundin edhe burimin e avúshave, díelli nje hér' e pá, se si mur u-bene valat, edhe shkoj Israeli, me kembë neper mes te detit, pertéj me keng' e brohorí: Le ta kendojme Zotin, te lavdëruar me lavdí.

III. Zoti Krisht qe i mpron besniket shpresëplote, forcoje dhe mproje Kishen e bekuar, qe e mbolle me vojte dhe me gjakun tent.

IV. Mbulove me virtuta qíellin o Zoti Krisht, kur linde prej Nenes Virgjereshe, dhe u-shpure ne Kise si foshnje ne peqí, dhe i mbushe te gjitha me lavdí dhe brohorí.

V. Te pá Shen Isaia simbolerisht, mi fron te larte si Perëndí, ne Parajsen te rethuar prej Engjejve, dhe thoshte i mjeri me tmerr: Ja e pashe Perendine si njerí, Zotin Shpetimtarin, qe na ndrit dhe na paqesón.

VI. Kur Simeoni te mori ne krahet, dhe pá shpetimin per pópullin, i gezuar thirri: Ti je Zot' i Math e ti je Krishti.

VII. Hodhe vesen permi zjarr, per Tre Djemte Shpetimtár, edhe linde virgjerisht prej Hyjlíndeses, Perëndí edhe Fjale, beserisht te kendojme, se i bekuar je ti o Perëndí edhe Zot.

VIII. Ne flag' e ne zjarr te bashkuar, te Tre

Djemat e bekuar te pangare, mun ne mes te furrës te vesuar, te kendonin me lavdí: E bekoní Zotin te gjithë me kenge, dhe e lartësoni perherë dhe per jete.

O Hyjlíndese Marí, shpres' e te Krishtéreve, mprona rúajna se ti, streha jon' e vetem je.

IX. Ne Ligjen dhe Shkronjen fáqeza, shohim shembell te Zotit Krisht: Çdo djal' i parelindur kish prej Zotit, hir edhe bekím. Dhe né pra Fjalën qe lindi, si Bir i pare ne qell, dhe djal' i pare permi dhé, me kendím e madheshtojme sot.

DERGIMGSORET, T. III, EPESKEPSATO

Me fjalime si florí, o Shen Grigór Patrik me nam, e ndrite Kishen e Zotit Krisht, dhe ke gezuar çdo besnik, dhe na u-çfaqë si kasnéc, i beses Orthodokse, dhe çpalles i dógmave.

Virgjereshe Hyjlíndese, o Nena e besníkeve, iu-lut perherë Zotit Krisht, per ndjesen e mekátave, tok me Patrikun Shen Grigór, dhe falna dhe dhurona, Parajsen e Engjejve.

LAVDËRIMET, T. I, TON URANION

E imitove Shen Janin Profetin Pagezór, o Atë nga permbajtja, dhe Eline Profetin, me kreshm' e agjerime dhe virgjerí, o Grigór Theollóg i Math, dhe i perbuze tiranet plot me kuxím, si barí i Shpetimtarit Krisht.

I frymesuar prej Fjales dhe prej Shkriptúrave, ndriçove terë boten, me mesimet e tua, o Atë Kry-

eprift Grigór Theollóg, çpalle qysh të pendohemi, dhe të kujtojmë të vërferit gjithënjë, pas Ungjillit të Zotit Krisht.

Me shpirt e zemër të paqme dhe të panjollshime, si yll edhe si diell, i ndriçove besniket, me dogma Orthodokse o Kryeprift, o Grigór Theollóg i Math, dhe trashëgove Parajsen pranë Jesújt, dhe kurorën e qiellit.

LAVDI, T. T. IV. Me fjale të florinjta, dhe me predikime të perëndishme, e stolise Kishën e Perëndisë, dhe ia rrite pasurite shpirtërore. Përndaj po të sjellim sot, një kurorë prej lulesh të pafishkura, për kujtimin e nderuar, o Shen Grigór Theollóg dhe Patrik i Math, dhe të perunjur të lútemi: Nermjetó pranë Krishtit, të shpëtohen shpirtet tona.

TANI. Prit-i Hyjlíndese, lutjet e shërbëtóreve, shpëtona gjithënjë, prej rezíkeve dhe hidhërimëve.

SHKURTORJA, T. IV, O MITRAN.

O Zot që e shënjtërove Marinë Hyjlíndese, dhe plakun Shen Simeón, e bekove në témpullin, arrí edhe taní, o meshireplót o Krisht Perëndí, edhe shtetin na e shpëtó prej gjithë lúfteve, dhe forcóji qeveritaret e pópullit, si mprojtes i njërcsve.

APOSTULLI

Goja ime do të flasë urtesí. Degjójini ketó, të gjithë kombet.

Prej Letres së Palit për Hebrenjtë.

Vellezër, një Kryeprift i ketille na duhej, i drejtë, i mirë, i paqme, i larguar prej mekatarëve, dhe më i lartë se qelli, i cili nuk ka nevojë, si kryeprifterinjtë e tjerë, të blatonjë thetore më parë për mekatarat e veta dhe pastaj për ató të pópullit, se këtë e bëri një herë, kur e blatój veten e tij. Se ligja i bën kryeprifter njërczit, që kanë dobësira, po fjala e besë pas ligjes e bën Birin të mbaruar për jetë. Me pakë fjale, kemi një Kryeprift të ketille, i cili ndënjí me të djathten e fronit të madhështisë në qell, një meshetár të shënjtërores dhe të tabernákullit të vertetë, të cilën e ka ngritur Zoti dhe jo njeriu.

UNgjILLI PAS JOANIT

Zoti tha: Une jam dera. Aý, që hyn me anën time, do të shpëtonjë, dhe do të hynjë, dhe do të dalë, dhe do të gjenjë kullotjë. Kusari nuk vjen veçse për të vjedhur, për të therrur dhe për të humbur, po une kam ardhur që tju jap jetë dhe tju jap jetë të tepër. Une jam bariu i mirë. Bariu i mirë ve shpirtin për dhentë. Po rogetari, i cili nuk është barí, dhe nuk i ka të tija dhentë, e sheh ujkun, që vjen, edhe i le dhentë, dhe iken, dhe ujku i rëmbén, edhe i çkaterrón dhentë. Dhe rogetari iken, se është rogetár, dhe nuk e ha malli për dhentë. Une jam bariu i mirë, dhe i njoh të miat, edhe të miat me njohin. Sikunder me njeh im-Atë, edhe une e njoh Atin, edhe ve shpirtin për dhentë. Kam edhe dhen të tjera, që nuk janë prej ketí

hoborri, edhe duhet t' i siell edhe ató; edhe do ma degjojnë zerin, edhe do të bëhen një kopé dhe një barí.

KUNGATORJA

I drejti do të kujtohet për jetë.

24. *Ksenia, Nena jone Oshenare.*

25. *Shen Grigori Theologu, Ati yne i Shenjte, kryepeshkopi i Kostandinopojës.*

PERLESHORJA E SHEN GRIGORIT, T. I.

Me fyellin e theollogjisë o kryebarí, munde trumbetat e gjithë oratóreve; se shtudiove thellësit' e mejtímeve, edhe gjete bukurít' e fjalímeve; nermjetó pranë Krishtit Perendí, Atë Grigór për né, të shpëtohen shpirtet tona.

26. *Ksenofoni, Ati yne Oshenár, me shoket e vete.*

PERLESHORJA E SHEN KSENOFONIT, T. I.

Perendí i Aterve, që na sillësh gjithënjé, me mirësi dhe butësi, mos e kursé perdellimin tent për né; me lutjet e Aterve tanc, qeveris-e jetën tonë me paqë.

27. *Trasferimi i lipsanit të Shen Joán Gojartit.*

PERLESHORJA E GOJARTIT, T. T. IV.

Fjala jote si një pishtár, shkelqeu dhe ndriti, botën e tërë me diturí; thesaret e varferisë na dhurój, dhe lartësin' e perunjësise na tregój. Po siç na rrite me fjale, Atë Shen Joán Gojarte, lutju

Krishtit Fjales Perendí, të shpëtohen shpirtet tona.

28. *Efremi Siriani, Ati yne Oshenár.*

PERLESHORJA E SHEN EFREMIT, T. T. IV, TES TON DHAKRION SU

Me lotë derdhur si rëké, shkretëtirën e that' e vadite për lërim, dhe me vajtím dhe psherëtím, gjer një qint herë për më blodhe për çdo mundím; u-çfaqë pra si yll, dhe e ndriçove botën me çdo çudí, o Shen Efrém o Ati yne Oshenár. lutju Zotit Krisht Perendí, të shpëtohen shpirtet tona.

29. *Trasferimi i lipsanit të Shen Ignatit, Hierodëshmorit të Shenjte dhe hyjprures.*

PERLESHORJA E SHEN IGNATIT, T. IV, QË TROPON METOKHOS

Shok i mënyrave, nekembës i frónëve, u-çfaqë kor' e Dishépujve, zbatove me veperím kudó, çdo teorí edhe predikím; perandáj të verteten e leçite prer' e drejt, dhe për besën leftove gjer në gjak, si një Dëshmor o Shen Ignát; lutju Zotit Krisht Perendí, të shpëtohen shpirtet tona.

30. *Triarkondet.*

PERLESHORJA E TRIARKONDEVE, T. I, TUS TRIS MEJISTUS

Të tre yjt' e mëdhënj të Trinisë së tridjëlleshme, që ndriçuan tërë botën me reze dogmash të hýjeshme, të tre lumenjtë mjaltëjedhës të urtesisë, që vaditnë krijesën me vala të qëllshme, Basilin

e Math, edhe Grigorin Theollóg, me Shen Joanin Gojartin, qe kishte gjuhen dhe fjalen si florí, gjithë dáshesit e fjáleve te tyre, le t' i nderojme me lavderime sot, se prane Shen Trinise, per né po nermjetojne gjithenjë.

THIRRTORET, T. IV, OS JENEON

Instrumentat e Zotit Krisht, dhe kitharat e Shpirtit Shenjt, dhe trumbetat gjemónjese te leçítjeve, qe proklamuan lavdín' e Perendise, te tre predikatoret e Trinise se Shenjte, Basilin e Math, edhe Grigorin Theollóg, edhe Joanin Gojarte, le t' i nderojme vlerésisht.

Perluftaret e Zotit Krisht, dhe kalóresit e Orthodoxeve, te tre Apostujte prej Dymbedhjetëve, luménjt' e Parajses me ujen e gjalle, qe vadihin kriesen me valat e doktrínave, le t' i nderojme vlerésisht.

Instrumentat e Shpirtit Shenjt, trumbetaret e dógmave, oratorët e Fjales se Perendise, le t' i kendojme me besë dhe le tu lútemi, te nermjetojne prane Zotit, te na dhuronje ndjesen e mekátave, dhe Parajsen e Engjejve.

LAVDI, T. II. Yj te mëdhénj me nam, qe ndritte Orthodoxet, dhe zbukuroat Kishen, te Shenjte Triarkonde, Basíl Grigór edhe Joán.

TANI. Ti je m' e lúmura, nga grat' e tere botes, se linde Shpetimtarin. Perkraha dhe dhurona, Parajsen e Shenjtóreve.

PASVARGJET, T. T. I, KHERIS ASKITIKON

Lum' ju o Kryeprifter me nam, ju o fortesa madheshtore te Kísheve, kollona edhe keshtjella, dhe themelí dhe shkembínj, qe u dhate daten heretikeve; leçites te dógmave, dhe barínj te besníkeve, qe i ushqyet, me virtutat e Zotit Krisht, dbuat újqerit, dhe i çdukte perçáresit; çpállesit e kanúneve, te Kishes se Zotit Krisht, o udheheqes te larte, qe ne Parajsen na shpini drejt. Pra Krishtit iu-lutni, te na fale per jete, meshire dhe shpetím.

Lum' ju o Kryeprifter me nam, Engjej qellore, qe baritte ketú mi dhé, shpetimin i dhate botes, dhe njerezise gezím, dhe u çpallte besen gjithë Kísheve; leçites te fjáleve, edhe mjekte te shpírteve, dhe çdo lengate trupesore te njéresve, te mëdhénj luménj dhe liqene te Shpirtit Shenjt; ju qe po rithni fúshave, dhe zbrisni luádheve, edhe vadihni kriesen me predikím te doktrínave. Pra Krishtit iu-lutni, te na fale perhere, meshire dhe shpetím.

Lum' ju o Kryeprifter me nam, yj te shkelqyer te krieses se njéresve, pishtare qe shkepetini, nje Perendí nje Triní, qe u jipni driten te verbúarve; o lule te búkura, te Parajses se Engjejve, myra qellore, Shen Basíl edhe Shen Grigór, edhe Shen Joán, o dishepuj te Shpirtit Shenjt; pllaka te gjithë dógmave, dhe kronj te sherímeve, qe derthni vala shpetimi, dhe urtesie te hýjeshme. Pra Kri-

shtit iu-lutni, te na fale perhere, meshire dhe shpetim.

LAVDI DHE TANI, T. II. Lum' o Kryepriftinj, se vreshten e punuat, dhe rogen e fituat, ne qell perpara Zotit; per ne pa prere lutuni.

NDENJESORET, T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Ndriçonjes te kísheve, te Zotit Krisht Perendí, leçites te dógmave, dhe predikímeve, dhe barínj te besníkeve, dermuat heretiket, dhe genjeshtrat e tyre, shuat te gjithë zjarret, dhe perçarjet e tyre; pra lutuni perpara Jesújt, per ndjesen e mekátave.

LAVDI DHE TANI. O Zonje Hyjlíndese, kerkesat tona i prit, dhe shpjer-i te lútemi, perpara Birit Jesú, dhe Zotit te qiellit; nxirna nga çdo shtrengese, se me ty po perikim, thýeji te paudhet, dhe dermoji armiqtë, qe na leftojne pa prece, ti o mprojtje e besníkeve.

T. IV, KATEPLLAJI IOSIF

Ne luadhin ungjillór, si fluturuat posht' e lart, kini mbledhur me kujdés, mjalte prej lúleve me zell, edhe ua shtruat besníkeve mi sofren; dhe ftoni cilindó, ne panaír dhe ne gostí, dhe si ha çdo mysafir, dhe embelsohet pa kufí, me brohorí therrét edhe ju thote: Ejani prape, o Kryeprifter, dhe na gezoni me besen e Zotit Krisht.

LAVDI DHE TANI. Ne furtún' e ne tufán, ne

pasione dhe ne zjarr, te therrés o Shen Marí, une i mbýturi ne zi, mos me harró dhe mos me neverít ne humbje; Nen' e Zotit Krisht, qe ke meshír' e dhempsherí, shprese tjater nuke kam, veç teje asgjekúnt, shpetome pra dhe mos i ler te gezohen armiqtë; e ke ne dore, posa te duash, se ti je Nen' e Zotit Krisht.

T. IV, EPEFANIS SIMERON

Me mesím dhe urtesí, boten e ndritte, dhe me vepra Zotin Krisht, e lavderuat permi dhé, ju madheshtojme pra sot me gas, si shpetimtare, te gjindjes se njéresve.

LAVDI. Sot me gas po ju kremtón, Kisha e Shenjte, te Tre Kryeprifterit, edhe Mesónjesit me nam, se shiguruat me themelí, besen e Krishtit, me anen e dógmave.

TANI. Virgjereshë mprójtese, per çdo nevojë, nermjetó per gjithë ne, qe kemi shprese permi ty, dhe na shpetó prej rezíkeve, o Nen' e Krishtit, o ndihm' e besníkeve.

SHKALLESA KREMTORE, T. IV

Qe prej djalerise, shume pasione me leftojne, po ti perkrah-me dhe shpetome, o Shpetimtari im.

Ju qe urreni Sionen, do te turperóheni prej Zotit, dhe do te fishkeni si bari ne zjarr.

LAVDI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, merr jete çdo shpirt, dhe lartsohet ne paqesi, dhe ndriçohet prej njesise Trinisore mistikerisht.

TANI. Me anen e Shpirtit të Shenjtë, rjedhin burimet e hirit, dhe vaditin tërc kriesen për jetelindje.

PARCVARGU. Prifternjt' e tu, o Zot, do të vishen me drejtësi, dhe Oshenaret e tu do të ngazellohen.

UNGJILLI I MËNGJESIT PAS JOANIT

Zoti u tha Judenjve, që i kishin ardhur: “Me të vertetë, me të vertetë po ju them: Aý, që nuk e hyn nga dera në hoborrin e dhënve, po ngjitet gjétkazi, aý është vjedhes edhe kusár, edhe aý, që hyn nga dera, aý është bariu i dhënve. Atí ia hap derën portari, dhe aý i therrët me enër dhente, dhe i nxier jashtë. Dhe kur i nxier jashtë dhente, barët përpara atyre, dhe dhente i vënë pas, se ia njohin zerin. Se nuk i vënë pas një të húaji, po ikin prej tij, se nuk ua njohin zerin të húajve.” Këtë parabolë ua tha Jesúj, po nuk i múarne vesh ató, që u thoshte. Jesúj, pra, u tha perserí: “Me të vertetë, më të vertetë po ju them se unë jam dera e dhënve. Të gjithë atá, që kanë ardhur përpara meje janë vjedhes edhe kusarë, edhe dhente nuk i degjuan. Unë jam dera. Aý, që hyn me anën time, do të shpëtonjë, dhe do të hyjë, dhe do të dalë, dhe do të gjenjë kullotjë.”

Psalmi 51 pa zë.

LAVDI. Me nërmjetimet e Kryepřífterve, o meshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

TANI. Me nërmjetimet e Hyjlíndesës, o meshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

Meshirome, o Perendí meshireplót, edhe shúaji paudhesít' e mia.

T. T. II. Buzet ju derthnë hir, o Ater Oshenarë, edhe Barínj u-betë, të Kishes dhe leçitte, një Perendí dhe një Triní.

SHKURTORJA, T. IV, EPEFANIS.

Kryepřífter të mëdhénj, t' Orthodoxisë, që lefuat pa kursím, për fen' e Zotit Jesú Krisht, mpónani né që thërresim sot: Eja shpëtona o Zot i meshírave.

SHTËPIA

Me dorën e fortë dhe me fuqinë qellore, o Zot i zemërdhëmpshur, e lartësive kishen tënde gjer në qell, me yjt' e mëdhénj dhe të ndriçim, Basilin e Math, Grigorin Theollóg, dhe Joanin Gojartë. Me nërmjetimet e tyre, o Shpëtimtár, o Zoti Krisht, largoje natën dhe mjégullën e armiqve, dhe ndritna né që të thërresim: Eja shpëtona, o Zot i meshírave.

SINAKSARI

Me tridhjetë të ketí múaji, kujtojmë Basilin e Math, Grigorin Theollóg edhe Joanin Gojartë, Aterit tanë të Shenjtë, dhe Mësónjesit Ekumenike.

Gjithë sot, kujtojmë Ippolitin, Papën e Romës,

Hierodeshmorin e Shenjtë, dhe shokët e tij, Ken-surinin, Sabainin dhe Krisinë, Dëshmoret e Shenjtë.

Gjithë sot, kujtojmë Theofilin e Ri, Dëshmorin e Shenjtë.

Me nermjetimet e tyre, o Perëndi, mëshirona. Amín.

ZBRITËSORET, T. III, KHERSON AVISOTOKON

I. Fundin edhe burimin e avushave, dielli një hér' e pá, se si mur u-bënë valat, edhe shkoj Is-raeli, me këmbë nëpër mes të detit, përtej me këng' e brohorí: Le ta këndojmë Zotin, të lavdëruar me lavdi.

III. Zoti Krisht që i mpron besniket shpresëplots, forcoje dhe mproje Kishën e bekuar, që e mbolle me vojtje dhe me gjakun tënt.

IV. Mbulove me virtuta qiellin o Zoti Krisht, kur linde prej Nenes Virgjëreshë, dhe u-shpure në Kishë si foshnjë në peqí, dhe i mbushe të gjitha me lavdi dhe brohorí.

V. Të pá Shen Isaia simbolërisht, mi fron të lartë si Perëndi, në Parajsen të rethuar prej En-gjëjve, dhe thoshte i mjeri me tmerr: Ja e pashe Perëndinë si njeri, Zotin Shpetimtarin, që na ndrit dhe na paqësón.

VI. Kur Simeoni të mori në krahët, dhe pá shpetimin për pópullin, i gezuar thirri: Ti je Zot' i Math e ti je Krishti.

VII. Hodhe veshen përmi zjarr, për Tre Djem-të Shpetimtár, edhe linde virgjërisht prej Hyjlíndesës, Perëndi edhe Fjalë, besërisht të këndojmë, se i bekuar je ti o Perëndi edhe Zot.

VIII. Në flag' e në zjarr të bashkuar, të Tre Djemat e bekuar të pangarë, munda në mes të furrës të vesuar, të këndonin me lavdi: E bekoni Zotin të gjithë me këngë, dhe e lartësoni përherë dhe për jetë.

O Hyjlíndese Marí, shpres' e të Krishtëreve. mprona rúajna se ti, streha jon' e vetem je.

IX. Në Ligjen dhe Shkronjen fáqeza, shohim shembell të Zotit Krisht: Çdo djal' i parëlindur kish prej Zotit, hir edhe bekím. Dhe në pra Fjalën që lindi, si Bir i parë në qell, dhe djal' i parë përmi dhé, me këndim e madhështojmë sot.

DERGIMËSORET, T. III, EPESKEPSATO

Ju o enë të ndrícime, o vetetima shkelqënjese, o Shen Basíl o Shen Grigór, edhe gojartë Shen Joán, kini leçitur besërisht, Ungjillin e shpetimit, për gjindjen e njëresve.

O Triní o Perëndi, o At' e Bir dhe Shpirti Shenjt, perunjësisht ju lútemi, për ndjesën e mëkátave, se nermjetón Basíl i Math, dhe Grigór Theologu, dhe Joani Gojartë.

Ti o kështjéll' e florinjte, me dymbëdhjetë fortësë, o fron që ndrit si dielli, ku rri Jesúj si Mbret dhe Zot, ti o çudí që s' ke kufí, o Nënë Virgjëreshë, dhe Zonjë Hyjlíndese.

LAVDERIMET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Ç' fare këng' e lavdí, me lule dhe kurore, si çmim do tu blatojmë, Mësónjesve të Kishes, të Treve Kryepërfiterve!

Ç' fjale me bukuri, të Treve do tu thomi, Basilit dhe Grigorit, edhe Joan Gojartit, leçitësve të dógmave!

Ç' mburrje dhe madheshtëm, të Treve do tu japim, kollónave të Kishes, barinjve të Krishtere, shërónjesve të shpërteve.

Ç' lutje dhe litaní, të Treve do tu bëjme! Pa prerë nermjetojnë, në qell të trashëgojmë, Parajsen e Shenjtóreve.

LAVDI. Shpirtet e njëresve, në qellin sot po ngrihen, se luten Triarkondet, përpara Jesú Krishtit, për ndjesën e mekátave.

TANI. Sot Zoti Jesú Krisht, në Témpullin po sillet, pas ligjes Mosaike, dhe Simeoni thote: Tani më perleshó o Zot.

SHKURTORJA, T. I, O MITRAN

O Zot që e shenjterove Marinë Hyjlíndese, dhe plakun Simeón, e bekove në témpullin, arrí edhe taní, o meshireplót o Krisht Perendí, edhe shtetin na e shpetó prej gjithë lúfteve, dhe forcoji qeveritaret e pópullit, si mprojtes i njëresve.

APOSTULLI

Fama e tyre u-perháp në tere botën. Qelli tregón lavdinë e Perendisë.

Prej Letres së Palit për Hebrenjtë.

Vellezer, bindjuni kréreve tuaj, dhe degjójini; se atá vigjellojnë për shpirtet túaja, meqéneqë do të japin fjale për këtë gjë; se atehere do të bëjnë me gezím dhe jo dyke psherëtitur; edhe kjo nuk është e dobishme për ju. Fáluni për né, se jemi të bindur që kemi ndërgjéggjie të kthjellët, se jemi përpjekur të sillmi mirë me të gjithë; dhe më tepër ju lutem ta bëni këtë gjë, që të vendosim më shpejt pranë jush. Edhe Perëndia i paqes, i cili e ngriti së vdekuresh barinë e math të dhënve, Zotin tonë Jesú, me gjakun e dhjates së perjetme, ju stervitë për çdo veper të mirë, që ta mbaroni dëshirën e tij, dhe ju bëftë si ta gjenjë të pelqyer me anën e Jesú Krishtit, i cili pastë lavdí në jetet e jéteve. Amin.

UNGJILLI PAS MATTHEUT

Zoti u tha Dishépujve: Ju jini drita e botes. Një qytét, i vendosur mi një mal, nuk e vë nën shinin, po përmi kandilerin, që tu ndrite të gjithë atyre, që ndodhen në shtëpi. Keshtú le të shkelqenjë drita juaj përpara njëresve që t' i shikojnë veprat túaja të mira, dhe ta lavdërojnë Atin tuaj, që është në qell. Mos pandehni se kam ardhur ta prish ligjen edhe profetët. Nuk kam ardhur ta prish po ta plotesónj. Se me të vertetë po ju them, gjer sa të prishet qelli edhe dheu, dhe gjer sa të mbarohen të gjitha, asnjé jotë dhe as-

një vije e ligjes nukë do të prishet. Aý, pra, që shkel më të vógelen prej këtyre porrosive, a i mesón njerezinë t' i shkelin, do të quhet më i vogeli në Mbretërinë e qellit; po cilidó, që i zbatón, dhe i predikón, aý do të quhet i math në Mbretërinë e qellit.

KUNGATORJA

I drejti do të kujtohet për jetë.

31. Kiri dhe Joani, Anargjendet e Shenjte dhe çudiberes.

PERLESHORJA E ANARGJENDËVE, T. T. IV.

O Shen Anargjendë Kir dhe Joán, vizitónani dhe shcrónani; darovísht e múarte, darovísht pra épnajeni.